

## TE KREMTET E NENTORIT

1. *Kozmáj dhe Damiani, Anargjendet e Shenjte dhe çudiberes; Theodota, Nena jone Oshenare.*

PERLESHORJA E ANARGJENDËVE, T. T. IV.

Shen Anargjendë çudiberes, Kozmáj dhe Damian, vizitónani dhe sherónani; darovisht e múarte, darovisht épnajeni.

THIRTORËT, T. T. II, OLIN APOTHEMENI

Terc shpresen lart ne qell, e kane patur Shenjtoret, dhe thesaret gjithatjé, shigurisht i mblothne edhe i rúajtin; darovisht i múarne, darovisht i dhane, gjith' ilaçet e lengátave, dhe nuke múarne, siç u tha Jesúj as argjént as ar; dhe njëresve dhe káfshëve, pa kursím u dhane sherím dhe hir; dhe me ketó vepra, u-bene Apostúj te Zotit Krisht, dhe nermjetojne perpara tij, per shpirtet e besníkeve.

Terc gazin permi dhé, e neveritne Shenjtoret, qytetare lart ne qell, truperisht u-çfaqne si gjithë Engjejte, me një mendje qe te dy, me një sjellje dhe një hir, me një shpirt dhe me një shenjterí, gjithë lengónjesve, pa ndryshím u dhane sherím dhe hir; dhe s' múarne asnjé çperblím, dhe asnjé pagese dhurónjesit; pra le t' i kremtojme, dhe le t' i lavderojme mot per mot, se nermjetojne me perdellím, per shpirtet e besníkeve.

Terc besen ploterisht, ne shpirt te tyre e patne, Damiani dhe Kozmáj, per Trinín' e Shenjte te

bashkeqénshime, dhe burojne çdo sherím, si nje krua pa pushím, per lengatat e te mjérove, kur lipsanet beserísht, lútesit u prekin Shenjtórove; pra emrat u kujtojmë sot, per sherím te shpejte te plágeve; se atá perhere, períkësit i prasin dhempsherísht, dhe nermjetojne me perdellím, per shpirtet e besníkeve.

LAVDI DHE TANI. Passi shkava shpirtërisht, i skllaveruar prej djallit, o Marí Hyjlíndese, pranc teje vinj dhe meshire ty te lyp; dhe kerkónj perdellím, Zonje Virgjereshe, un' i mjeri i húmburi. Prit-me dhe mpro-me pra, nga furtún' e keqe e ngásjeve, shpetome dhe çlirome ti, nga goditj' e rrept' e demóneve; se me mall perhere, dhe me besë t' adhurónj dhe te hymnónj, te madheshtónj dhe te lavderónj, Zonj' e lumerúarshme.

#### PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Uja ne Silloám, ne vit nje here vetem, sheronte te semuret, po ju o Anargjende, per dite falni çdo sherím.

S' doni florí mi dhé, se mblithni ar ne qellin, o shoke te bekuar, eni na vizitoni, dhe shpirt e trup sherónani.

Engjej te zémrave, sheroni pa pagese, te but' e te perunjur, kudó dyke shetitur, lengatat e besníkeve.

LAVDI DHE TANI. Gjithenjë veperón, me anen tuaj Krishti, se sipas porrosive, te tij kini sherbyer, Kozmá dhe Damián me nam.

#### NDENJESORET, T. T. IV, TIN SOFIAN

Qe prej qellit e múarte darovísht, dhuretín' e çudive prej Zotit Krisht, sheroni pra gjithenjë, çdo semundje dhe çdo pesím; se treguat qe kishit, me hirin e Shpirtit Shenjt, nje fuqí mjekesore, te dhene qe lártazi; pra u-vleresuat, per te mirat qellore, me besë dhe me sherbím, pa pagese dhe pa çperblím; Anargjende te Shenjte, kerkoni prej Zotit Krisht, te na dhuronje ndjesen e mekátave, neve qe po kremtojmë, kujtimin tuaj beserísht.

LAVDI DHE TANI. Kur e pá permi Kryqin Birin e saj, si nje shqerre te therrur Krishtin barí, Maria Hyjlíndese llogoriste me vaj dhe lot: Mjer' o drit' e botes, o Zot edhe Perendí, pse ketó te gjitha i vuan vullnetarisht? Tere njerezise, dó shpetimin t' i falesh, dhe jeten e qíellit, tu dhurósh te varrósurve. Madheshtojme pesimet, qe vojte per né o Zot, nga meshira jote pa kufí dhe funt, dhe na shpetove nga Ferri, me vdekjen e hýjcshme.

*Meqéneqe nuke ka Ungjill te Mengjazit, kendohet me-njehere:*

#### SHKURTORJA, T. II

Passi múarte hirin, po i sheroni qe te gjithë sa dergjen me semundje, o Mjeko çudiberes me lavdí; keshtú i dermoni ushterít' e demóneve, dhe u falni shendetin besníkeve.

## SHTËPIA

I kini kapercyer te gjithë mjeket nga urtesia dhe dituria, dhe i sheroni te gjithë te semuret e dhe vójtesit; keshtú i dermoni ushterít' e demó-neve, dhe u falni shendetin besníkeve.

## SINAKSARI

Me nje te ketí múaji, kujtojme Kozmanë dhe Damianin, Anargjendet e Shenjte dhe çudiberes, te bijte e Theodotes prej Asise.

Gjithe sot, kujtojme Qyranen dhe Julianen, Dëshmoret e Shenjta.

Gjithe sot, kujtojme Kesarin dhe Dasin, Dëshmoret e Shenjte, me pesc shoket e tyre.

Gjithe sot, kujtojme Peshkopin Joán edhe Priftin Jakób, Hierodëshmoret e Shenjte.

Gjithe sot, kujtojme Hermenigelldin, Dëshmorin e Shenjte.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona dhe shpetona. Amín.

## ZBRITËSORET, T. IV, ANIKSO

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpirtit Shenjt, dhe kenge do t' i kendónj, Nenes se Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle buzeqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithë çudit' e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendise, burím i pasosur jetesór, ti shiguroji gjith' atá, qe te kendojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón, kurorëzoji me çdo lavdí.

IV. Te pagjyrmesúarin pllan perendór, qe po misherohet i larti Zot prej Virgjereshes, Abakumi si Profét, e pá dhe tha me ze te math: Zot i fuqishim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje lavdí: Ti o Virgjerësh' e pamartuar, Zotin e jetes qe mbreterón lart ne qell, si nje bir e mbajte ne peqí dhe shpetím qe lártazi, u dhurove besníkeve.

VI. Keté te kremte e lusim sot, per Zonjen e dhe Nenen Hyjlíndese, gjithë hyjméndesit, eni trokisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin qe lindi prej asáj.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjméndesit, po Krijetarit lart, dhe kercenimin me zjarr, e shkelne me trimerí, psallnin me brohorí: Zot lavdí me ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Djemat e denuar per te djegur, prej zjarrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si simból ne vjeterí, dhe si veperím taní, dhe terc boten po e mbleth per keng' e lavderím: Hymnójeni ju veprat e Zotit, dhe e lartesoní permi te gjitha jetet.

IX. Gjithe njérezit, keceni me ngazellím tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Çngjcejt' e qellit eni kremtójeni, keté te shenjte panair te Kryezonjes Marí, dhe therrisni: Ti je mé e lúmura, Virgjerësh' e kulluar Hyjlíndese.

## DERGIMËSORET, T. III, EPESKEPSATO

Mjekesine qe lártazi, nga Zoti Krisht e múarte,

edhe sherime darovísht, perndani neper vójtesit; pra ju kremtojmë sot me mall, edhe ju lumërojmë, për mot dhe perherë.

Na linde o Hyjlíndese, Jesúne Krishtin Perendí, që tere boten e shpetójt, nga Ferri i demóneve; shpetona nga smundjet pra, nga helmet dhe mekatat, me lutjet e dhémshura.

#### LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Per te sheruar smundjet nga Krishti múarte, fuqí edhe dhurate, dhe pa roge dhuruat, sherime darovísht kudó pa çperblím, gjithashtú siç i múarte; pra nermjetoni në qell pranë Zotit Krisht, për shpetimin e besnikëve.

O Anargjende te Shenjte Kozmá dhe Damián, o Engjej te Parajsës, që baritte mi dhene, perhap-te ngazellím shendét dhe sherím, darovísht pa nonjë çperblím; pra nermjetoni në qell pranë Zotit Krisht, për shpetimin e besnikëve.

Per te semuret e mjere dhuroni çdo sherím, edhe shpetoni trupet e besnikëve tuaj, ashtú sikunder benit mi dhé, dhat' ashtú siç i múarte; pra nermjetoni në qell pranë Zotit Krisht, për shpetimin e besnikëve.

LAVDI, T. T. IV. Si te mos çudítemi? Si te mos hymnojmë çudirat túaja te panúmerta, o Anargjende te lavderuar? Se edhe pas vdekjes na falni sherime, o Mjete te shpírteve dhe te trúpeve tona.

TANI. Prit-i Hyjlíndese, lutjet e sherbetóreve,

perkrahna dhe shpetona, prej rezíkeve dhe hélmeve.

#### SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA.

O mburónj' e patronditur e te Krishtéreve, nermjetare e palodhur e besnikëve, ver-u veshin mekatáreve me dhémsherí, se po te therresim beserísht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjereshë: Ndhna me nermjetimet, dhe lutjet meshireplote, dhe mpro perhere gjith' atá, që te lusin o Hyjlíndese.

#### APOSTULLI

Zoti beri çudira mi dhene me anen e Shenjtóreve te tij. E kam patur Zotin gjithenjë perpara syve.

Prej Letres I se Palit per Korinthianet.

Vellezer, jini trupi i Jesújt te gjithë tok, edhe mise te tij veç e veç. Dhe Perendia vuri krere në Kise, te paren Apostujte, te dyten Profetet, te terten Mesónjesit, pastáj njerës me potera, me dhurata sherimesh, me perkrahje, me qeverira, dhe me gjuhe te ndryshme. Valle mos jane te gjithë Apostújt? Apo mos jane te gjithë me potera? Apo mos kane te gjithë hire sherimesh? Apo mos flasin te gjithë gjuhe te ndryshme? Apo mos perkthejne te gjithë? Kini zilí per dhuratat mé te mira, po une ju tregónj nje udhe mé te bukur. Edhe sikur t' i flas te gjitha gjuhët e njéresve dhe te Engjejtve, po dashurí te mos kem, jam si rame, që oshetín, a si kimbál, që bumbullín. Edhe

ne paça dhuraten e profetisë, edhe t' i di të gjitha dituritë, edhe në paça aqë besë sa t' i çvendós malet, po dashuri të mos kem, nukë fitónj asgjé. Dashuria ka zemër të gjërë dhe fisnike; dashuria s' ka zilí; dashuria nukë mburret, nukë fryhet, nukë bën gjera të shemtúara, nukë kerkón interesat e veta, nukë ndizet, nukë mejtón të keqen, nukë gezohet për padrejtësinë, po për të drejtën; dashuria i vuan të gjitha, i durón të gjitha. Dashuria nukë përmbysët kurrë.

#### UNGJILLI PAS MATTHEUT

M' até kohë, Jesúj i ftoj të dymbëdhjetë Dishépujtë, dhe u dha fuqí që t' i nxírin demonet e paudhë, edhe t' i sherojnë të gjitha semundjet edhe lengatat. Edhe Jesúj, kur i dergój, i porrositi, dhe u tha: "Mos hiqni në viset e pagáneve, dhe mos hyni në qytetet e Samarítáneve, po më teper shkoni në dhentë e húmbura të shtëpisë së Israhelit. Edhe kur të veni, leçitni, edhe thoni se u-af-rua Mbretëria e qellit. Sherójini të semuret, pagczójini leprozët, ngjállini të vdëkurit, nxíri-ri demonet. Darovísht i múartë, darovísht i jepni.

#### KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet për jetë.

2. *Akindi, Pegasi, Afthoni, Elpidofori, dhe Anembodisti, Deshmoret e Shenjte.*

3. *Akepsimaj, Josefi dhe Aithalláj, Deshmoret e Shenjte; Dedíkata e Kishes së Shen Gjergjit në Lyde, domethene varrimi i kufomes së tij.*

#### PERLGSHORJA E SHEN GJERGJIT, T. IV.

Si çlirimtár i róberve dhe mprojtes i të vobé-keve, mjeku i të semúreve dhe perluftár i mbré-terve, Deshmór i Math Shen Gjerq Tropeprures, nermjetó përpara Krishtit Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

#### PERLGSHORJA E DESHMORIT JOSEF, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmoret e tu o Zot, më vojtje lot e mundím, kurorë të ndrícime prej teje múarne, si roge dhe si çpërblím; se më fuqinë tënde, i rrezuan tiranët; edhe i shtypnë djajtë, e kuxímt' e të dobet; atá për në po të luten o Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

4. *Joaniqi i Math, Ati ynë Oshenár; Nikandri, peshkopi i Myres, dhe Pifti Hermeu, Hierodeshmoret e Shenjte.*

#### PERLGSHORJA E SHEN JOANIQIT, T. T. IV, TES TON DHAKRION SU

Më lote derdhur si reké, shkretëtirën e that' e vadite për lerím, dhe më vajtím dhe psherëtím, gjer një qint herë për më mblodhë për çdo mundím; u-çfaqë pra si yll, dhe e ndrícove botën më çudí, o Joaníq i Shenjte dhe Oshenár, lutju Zotit Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

5. *Gallaktioni dhe e shoqja Epistema, Deshmoret e Shenjte.*

6. *Pali Konfessori, Ati ynë i Shenjte, kryepeshkopi i Kostandinopojës.*

PERLESHORJA E PALIT TË KOSTANDINO-  
POJGJ, T. III, THIAS PISTEOS

Bes' e Zotit Krisht e proklamuar, si një tjetër Pal për Kishën tonë, të tregoj në Priftërinjtë si një zellót. Me ty Abeli therrët për drejtësi, dhe Zaharia për gjakun kerkón çpagím. Atë Oshe-nár, bëj lutje përpara Zotit Krisht, që të na falë përdellimin e math.

7. *Te Tridhjetë e Tre Deshmorët e Shenjtë të Meliti-nes; Lazari, Ati ynë Oshe-nár dhe çudibërës i Galilese.*

PERLESHORJA E SHEN LAZARIT TË  
GALILESE, T. T. IV, TES TON DHAKRION SU

Me lotë derdhur si reké, shkretëtirën e that' e vadite për lërim, dhe me vajtím dhe psherëtím, gjer një qint herë peme mblodhe për çdo mundím; u-çfaqe pra si yll, dhe e ndriçove botën me çdo çudí, o Atë Lazár i Shenjtë dhe Oshe-nár, lutju Zotit Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

8. *Shen Mehílli.*

PERLESHORJA E SHEN MCHILLIT,  
T. IV, O IPSOTHIS

O gjenerál i ushtrive të qellit, në shërbetoret e pavyer degjona, dhe mprona gjithënjé dhe nermjetó pa pushím, hap-i fletet mi të gjithë né, dhe mbulona me dritë, né që po të lútemi, dhe therrsim me besë: O Shen Mehíll shpëtona me nxitím, prej çdo reziku, si prijës i Çngjējve.

THIRRTORËT, T. I, TON URANION

Le të kremtojmë mi dhënë ashtú si Çngjējte,

dhe Perendinë tonë, përmi fron të lavdisë, i Shenjtë je le t' i therrsim me zë, ti o Ati i qëllësh-më, o Perendí edhe Fjalë o Jesú Krisht, edhe ti o Zot o Shpirti Shenjt.

Si kryetár i Fuqive të përmiqëllshime, që rri përpara fronit, të lavdisë përjetme, o díell i pashuar o Shen Mehíll, gjenerali i Çngjējve, nga çdo nevojë çdo ngasje dhe çdo rezík, na shpëtó né që të lútemi.

I par' i Çngjējve je Shen Mehíll i Math në qell, dhe meshetár i dritës, dhe lavdisë qellore, shpëtona edhe mprona me përdellím, prej të gjithë rezíkeve, se ja për mot të nderojmë me bes' e mall, me Trinín' e bashkëqénshime.

LAVDI DHE TANI. Gezóhuni bashkë me né, o Forca Çngjellore, se sot po kremtojmë panairin e kryetarit tuaj. Perandáj po i therrsim: Mbulona nënë hien e fléteve të tua, o Krye-çngjell Shen Mehíll i Math.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

O Kryegjenerál, o Shen Mehíll o Çngjell, o Gabriél i Shenjtë, që i këndon Zotit, përherë hymnin Trishenjtór.

Zjarr nga fytyra je, i bukur i çudíçim, o Shen Mehíll o Çngjell, o Gabriél i Shenjtë, o Krerë të gjith' Çngjējve.

Rini reth e përqárk, të Lartit në të lartat, këndon Trishenjtórin, atjé pra nermjetoni, për ndjesen e mëkátave.

LAVDI DHE TANI. O Shen Mehíll me nam, o

Engjelli i Parajsës, shpetona nga mekatat, shërona nga lengatat, me ndihmen e Hyjlindësës.

#### NDËNJËSORET, T. IV, O IPSOTHIS

O gjeneral i ushterive qellore, që po qëndrón përpara Zotit dhe Mbretit, dhe po shkelqén me driten që burón prej atí, çelna shenjterona ti, né besniket kendonjes, na çliró dhe na shpetó, nga pusít' e armikut, edhe dhuroji paqen gjithënjé, pópullit tonë, dhe gjithë besnikëve.

LAVDI DHE TANI. Të perhirojme gjithënjé Virgjereshe, dhe të hymnojme pa pushuar prej zemre, për dhëmpshërinë tendë né besniket e tu, lútemi me zë të math: Nen' e Shenjtë degjona, eja dhe shpetona shpejt, nga armiqt' e padukur, nga çdo pusí rezík dhe kërcením, se ti përherë, na mpron o Hyjlindëse.

Të shumësishmet Kerubím' e Serafime, dhe ushterít' e Krye-éngjajve të Zotit, Potera Forca Zotcsí dhe Kryesí, lútemi përkrahani, nermjetoni pa prërë, pranë Jetëdhënsit, Perëndisë dhe Zotit. Degjona pra o Zoti Jesú Krisht, edhe shpetona, besniket dhe pópullin.

#### LAVDI DHE TANI, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Shpejtó edhe na përkrah, dhe na shpetó pa voním, se po robróhemi, prej një armiku pa shpirt, o Krisht Perëndí dhe Zot. Thýjeji pra me Kryqin, kundërshtaret leptonjes, jepu të kuptojnë, ç'

forçë ka besa jonë, me lutjet e Shen Marisë, o mik i njërcësve.

#### T. T. IV, TO PROSTAKTHEN

O gjenerale Krye-éngjaj kryetare, të ushterive éngjellore të Parajsës, Shen Mehíl dhe Shen Gavríl të lavdëruar; të gjithë, Éngjajt' e ndriçim reth e përqark, pas fronit, të Perëndisë lart në lavdí, që nermjetojnë pa prërë dhe pa pushím, për mekataret përmi dhé, për hir për ndjes' e për shpetím, në ditën e gjykátave.

LAVDI DHE TANI. O Shen Marí o Virgjëresh' e pacinuar, përpara Zotit Jesú Krisht të lavdëruar; që ke lindur për shpëtimin e njeriut, pa prërë, për mekataret nermjetó, dhe ndjesë, për të Krishterët lyp e kerkó, tok me Éngjajt' e Krye-éngjajte, që të shpëtojnë nga çdo dením, dhe të fitojnë gas pa mbarím, në Parajsën e Shenjtóreve.

#### SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojnë, po ti përkrah-më dhe shpëtojnë, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionen, do të turpëroheni prej Zotit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqesí, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, edhe vaditin tërë krijesën për jetelindje.

PARGVARGU. Frymet janë Ɖngjejt' e tu, flaga dhe zjarri janë shërbetoret e tu.

### UNGJILLI I MƉNGJËZIT PAS JOANIT

Zoti tha: Shikoni, mos përbuzni asnjë nga këta të vëgjelit, se po ju them, se Ɖngjejt' e tyre qëndrojnë përpara faqes së Perëndisë në qell, se i biri i njeriut ka ardhur për të shpëtuar të humburit. Vullë nukë ju duket që, nëqóftesë një njeri ka një qint dhënë, dhe i arratiset një prej atyre, nuk i le të nëntedhjet' e nëntat, edhe shkon në malet, edhe e kërkón të humburën? Edhe nëqóftesë e gjen, me të vertetë po ju them se gëzohet për atë më tepër se për të nëntedhjet' e nëntat e paarratisura. Kështú për Ati juaj në qell nukë dó që të humbasë një prej këtyre të vëgjelve. Dhe nëqóftesë yt vullá mekatón përpara teje, eë dhe e qertó në mes teje dhe atí vetëm; nëqóftesë të degjón, e fitovë tet vullá; nëqóftesë nukë të degjón, merr me vetë edhe nonjë a dy shokë, që të kësh dy a tre dëshmorë; edhe në mos degjofte prapë, atëherë thúaji Kishës; edhe në mos e degjofte as Kishën, atëherë quáj-e si nonjë pagán edhe publikán. Me të vertetë po ju them: Sa të lithni mi dhënë, do të jenë të lídhura mi qellin; dhe sa të zgjithni mi dhënë, do të jenë të zgjídihura në qellin. Dhe përseri po ju them që, nëqóftesë dy veta mi dhënë merren vesh, çdo gjë, që të lypin, do tu jipet prej Atit tim në qell. Se atjë, ku janë dy a tre veta të mbledhur me emrin tim, atjë jam në mes të tyre edhe unë.

*Psalmi 51 pa zë.*

LAVDI. Me nërmjetimet e Ɖngjejvë, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nërmjetimet e Hyjlíndesës, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

*Meshirome, o Perëndí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.*

T. II. Rini reth e përqárk, të Lartit në të lartat, këndoní Trishenjtorin, atjë për nërmjetoni, për ndjesën e mekátavë.

### SHKURTORJA, T. II.

O Shen Mehíll o Shen Gavríll meshetare të Zotit, udhëhíqni çdo njeri, me të gjithë Ɖngjejt' e tjërë, nërmjetoni për gjithë njërezit, pranë Zotit Jesú Krisht, posi gjenerale të gjith' Ɖngjejvë.

### SHTËPIA

Ke thënë në Shkripturat e tua, o Zot njeridashës i pavdekur, se Ɖngjejtë gëzohen në qell për çdo njeri, që pëndohet. Përandáj të lútemi në mekatarët të na meshirósh, edhe të na falësh ndjesën, se për në të gjithë nërmjetojnë gjeneralet e gjith' Ɖngjejvë.

### SINAKSARI

Me të të ketí múaji, kujtojmë mbledhjen e Shen Mchíllit edhe Shen Gabrielit, kryenjërralëve të Ɖngjejvë, si edhe të gjithë Fórcavë Ɖngjellore të Shenjta.

Gjithashtú kujtojmë të Nentë Urdhëret, Keru-

bimet, Serafimet, Fronet, Zoterimet, Fuqite, Kryesite, Forcat, Krye-engjete dhe Engjete.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

#### ZBRITGSORET, T. IV, ANIKSO.

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpirtit Shenjt, dhe kenge do t' i kendónj, Nenes se Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle buzeqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithë çudit' e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendise, burím i pasosur jetesór, ti shiguroji gjith' atá, qe te kendojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón, kurorezoi me çdo lavdí.

IV. Te pagjyrmesúarin pllan perendór, qe po misherohet i larti Zot prej Virgjereshes, Abakumi si Profét, e pá dhe tha me ze te math: Zot i fuqishim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje lavdí: Ti o Virgjeresh' e pamartuar, Zotin e jetes qe mbreterón lart ne qell, si nje bir e mbajte ne peqí dhe shpetím qe lartazi, u dhurove besnikëve.

VI. Keté te kremte e lusim sot, per Zonjen e dhe Nenen Hyjlíndese, gjithë hyjméndesit, eni trokisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin qe lindi prej asáj.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjméndesit, po Krijetarit lart, dhe kercenimin me zjarr, e shkelne me trimerí, psallnin me brohorí: Zot

lavdí me ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Djemat e denuar per te djegur, prej zjarrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si simból ne vjeterí dhe si veperím taní, dhe tere boten po e mbleth per keng' e lavderím: Hymnójeni ju veprat e Zotit, dhe e lartsoni permi te gjitha jetet.

IX. Gjithë njérezit, kecení me ngazellím tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Engjete e qellit eni kremtójeni, keté te shenjte panair te Kryezonjes Marí, dhe therrisni: Ti je mé e lúmura, Virgjeresh' e kulluar Hyjlíndese.

#### DERGIMGSORET, T. III, EPESKEPSATO

Perluftár te njéresve, o gjenerál i Engjejeve, o Shen Mehíll ty te tregój, i madhi Perendí dhe Zot; pra Trishenjtorin i kendón, dhe kenge triumfale, per festat e qëllshime.

Na linde o Hyjlíndese, Jesúne Krishtin Perendí, qe tere boten e shpetój, nga Ferri i demóneve; shpetona nga semundjet pra, nga helmet dhe mekatat, me lutjet e dhémpshura.

#### LAVDERIMET, T. I, TON URANION

O kumandár i ordive qellore t' Engjejeve, dhe mprojtës i palodhur, i njeriut mi dhene, rúajtës besnik te hymnojme me mall, Shen Mehíll kryegjenerál, dhe po te lútemi eja dhe na shpetó, nga çdo dhembje çkaterrónjese.

O kryetar i fuqive te perendishme lart, e mblo-

dhe njerczine, nga gjith' anet e botes, sot ne keté panair dhe kremtím, buzeqeshur me Engjejte, qe t' i kendojme te Lartit plot me gezím, Trishenjtorin e besnikëve.

Ne hien tende perikim qe te mbulo'hemi, prej fléteve te tua, Shen Mehíll Krye-engjell, rúajna dhe mprona kudó, edhe n' oren veçanerisht, kur t' apim shpirtin ne dúart' e Zotit Krisht, na perkráh edhe na shpetó.

LAVDI, T. T. I. Ku mbreterón hiri yt o Krye-engjell, andejza dbohët forca e djallit; se Satani i rrezuar nukë munt te qendronjë nene driten tende. Perandáj pra te lútemi, shúaji shigjetat e zjarrta, qe levizin kunder nesh, edhe shpetona me nermjetime nga skandalet e tij, o Krye-engjell Shen Mehíll i lavderuar.

TANI. Te lumerojme o Hyjlíndese Virgjreshë, dhe te lavderojme né besniket pas detyres, o qytét i patundur, o keshtjéll' e patronditur, o mprojtje e pathyer, dhe perikje e shpírteve tona.

#### SHKURTORJA, T. IV, O IPSOTHIS

I permipaqmi Tempull i Shpetimtarit, e permishenjta nuserore e virgjër, dhe ark' e art' e ndrícime thesár' i Zotit Krisht, sot po sillet me lavdí, ne shtepín' e Perendise, dhe hirin brenda po na sjell, plot me Frymen e Shenjte, pra e hymnojne Engjejte me brohorí: Kjo ketú eshtë, banesa e qéllshime.

#### APOSTULLI

Frymet jane Engjejt' e tu. Bekoje Zotin, o shpirti im.

Prej Letres se Palit per Hebrenjte.

Vellezer, neqóftese eshtë e vertete fjala, e folur prej Engjeve, qe çdo çbaritje dhe çdegjím denohet sipas se drejtes, valle si do te shpetojme né, qe kemi plogeruar shpetimin e math, te cilin na e leçiti Zoti, dhe na e vertetuan atá, qe kanë degjuar, dhe te cilin na e deshmoj Perendia me shenja dhe me çudira dhe me fuqira te ndryshme dhe me dhurata te Shpirtit te Shenjte, te ndara pas deshires se tij. Se boten e pritme, per te cilen flasim, nuk e shtroj nene úrdherin e Engjeve. Edhe na e deshmon Shkriptura, e cila thote: "Ç' eshtë njeriu, qe e kujtón, a i biri i njeriut qe e vizitón? E vogelove pakez nga Engjejte; e kurorëzove me nder dhe me lavdí; e vendose mi veprat e dúarve te tua; i shtrove te gjitha nen' úrdherin e tij." Thote se nukë la asgjé te pashtruar nen' úrdherin e tij, po keté gjë nuk e shohim taní per taní. Edhe shohim se Jesúj eshtë ay, i cili u-vogelua pakez nga Engjejte, se e shkeli vdekjen, dhe u-kurorëzua me nder dhe me lavdí, dhe e ngjeróje vdekjen per te gjitha me hirin e Perendise. Se duhej ay, qe i ka bere te gjitha, dhe ka lavderuar shume bij, ta perfektonte Shpetimtarin e tyre me anen e pesímeve.

## UNGJILLI PAS LUKAJT

Zoti u tha Dishépujve: “Aý, qe ju degjón ju, me degjón mua; dhe aý, qe ju perzúz ju, me perbúz mua; dhe aý, qe me perbúz mua, perbúz até, qe me ka derguar.” Edhe te Shtatedhjetet u-kthyen prape me gas, edhe i thane: “O Zot, edhe demonet na binden me emrin tent.” Edhe Jesúj u-tha: “E pashe Satanin qe u-rczua nga qelli si rufé. Ja ku ju jap fuqí te shkelni mi gjerperinj edhe agrepe dhe mi tere poteren e armikut, edhe asgjé nukë do tju benje dem. Po mos u-gezoni per keté, qe frymat ju binden, po u-gezoni me teper qe emrat túaja jane shkruar ne qell.” Edhe m’ até ore, Jesújt iu-gezua shpirti, dhe tha: “Te perhirónj, o Atë, o Zot i qellit edhe i dheut, qe ketó ua ke fshehur te úrteve dhe te ménçurve, dhe ua ke zbuluar fóshnjave. Po, o Atë, se ashtú te pelqeu mé mire.”

## KUNGATORJA

Frymet jane Engjejt’ e tu. Flaga dhe zjarri jane sherbetoret e tu.

9. *Onesifori dhe Porfiri, Deshmoret e Shenjte; Matriona, Nena jone Oshenare.*

10. *Olimbáj, Erasti, Sosipatri, dhe Kuarti, prej te Shtatedhjete Apostujve te Shenjte; Oresti, Deshmori i Shenjte.*

PERLESHORJA E SHEN ORESTIT,  
T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmori yt o Zot, me vojtje lot dhe mundím,

kurore te ndrícime prej teje mori sot, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, ka rrczuar tiranet, dhe ka dermuar djajte, e kuxímt’ e te dobet; aý per né po te lutet o Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

11. *Mináj, Viktori dhe Vikenti, Deshmoret e Shenjte; Stefanida, Deshmorja e Shenjte; Shen Theodori Studiti, Ati yne Oshenár dhe konfesór.*

PERLESHORJA E THEODORIT STUDITIT,  
T. T. IV, ORTHODOKSIAS ODHIFE

Udheheqes Orthodóks, dhe mesonjes i beses dhe i perkores je, se na ke ndritur si nje yll, dhe u-tregove si shembell e Kryeprífterve, i urte Theodór, te gjithë i ndrícove dhe i mesove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

PERLESHORJA E SHEN MINAJT, T. IV,  
TAKHI PROKATALLAVE

Deshmoret e tu o Zot, me vojtje lot e mundím, kurore te ndrícime prej teje múarne, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, i rrezuan tiranet; edhe i shtypne djajte, e kuxímt’ e te dobet; atá per né po te luten o Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

12. *Shen Joani Eleimoni, Ati yne i Shenjte, Kryepeshkopi i Aleksandrise, dhe Nili, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E JOAN ELEIMONIT, T. T. IV

Durove dhe fitove çperblimin per mundimet,

Ate Oshenár, me lutje të paprera edhe me agjerrime; i ke dashur të mjeret, edhe i ke përmbajtur; nermjetó pra përpara Zotit Krisht, të shpëtohen shpirtet tona.

*13. Shen Joani Gojarti.*

PERLESHORJA E GOJARTIT, T. T. IV.

Fjala jote si një pishtar, shkelqeu dhe ndriti, boten e tërë me dituri; thesaret e varferisë na dhuroj, dhe lartësin' e përunjësise na tregoj. Po siç na rrite me fjale, Ate Shen Joán Gojarte, lutju Krishtit Fjalës Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

THIRRTORET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum' ti o Kryepërfít shembellór, ti o kollonc, e patundur e Kísheve, lavdí e Orthodoksise, që ke buruar çudí, lum' i dashurisë, që po rjeth për né; o yll që shkelqén dhe ndrit, instrumenti i Shpirtit Shenjt, mëndje qellore, zemërbuti me hir dhe nder, i stolísuri me virtút dhe përunjësi; o meshetár dhe Shenjt me nam, o Engjell i qíellit, o punctór i vreshtës, o mik i fjeshtës i Zotit Krisht; pra lutju pa prerë, që besnikëve tu fale, meshirë dhe shpëtim.

Dhënë dhe qellin e trashëgón, si zemërbutë, që u-çfaqë në njërczit, o áte i lavdëruar, që me fuqí dhe me ment, dhe me fjale t' urta, dhe me hir qellór, armiqtë e Zotit Krisht, heretikët e liq për ment, i shtype fare, edhe besën e hýjeshme, dhe

shpëtonjëse, lart e ngrite me Shpirtin Shenjt; ti u tregove Kísheve, me drit' e me predikim, ta lavdërojnë Jesunë, të bashkëqenshim në një Triní; me Atin pa nisje, që i fali botës, meshirë dhe shpëtim.

Brenda në tempull brenda n' alltár, i shenjteruar, ke shkelqyer si kryepërfít, me vepra dhe teorira, me urtesí dhe me ment, veshur me stolira të shkelqýera; taní pra në qíellin, përpara Zotit o Oshenár, n' alltár të lartë, po meshón tok me Engjëjtë, si ketú mi dhé, nëpër Kishet e njëresve; mos na harró po na kujtó, Joán Kryepërfít i math, né që po lusim me besë, kujtimin tënt edhe nermjetó; për né kurdoherë, që Jesújt të na dhuronjë, meshirë dhe shpëtim.

LAVDI DHE TANI, T. II. Një Perendí dhe Zot, dhe një Triní të Shenjtë, me Atin edhe Birin, dhe Shpirtin e bekuar, leçite Shen Joán me nam.

PASVARGJET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum' ti o instrumént muzikál, i frymesuar prej Jesújt dhe prej Engjëjve, që fole dhe predikove, dhe keshillove me zell, edhe na mesove të pendóhemi; i urtë i artë Shenjt, dallëndryshe këndonjëse, pullúmp i bukur, ligjëronjësi i psállmeve, si florí shkelqén, në luáth të virtútave; krua midis lëndínave, që rjeth midis lúleve, o goj' e shenjte që solle, vellazerí midis njëresve. Iu-lut Jesú Krishtit, të na fale kurdoherë, meshirë dhe shpëtim.

Lum' ti që mpron jetimet si At, ti o perikje e të gjithë të shtëpurve, o mprojtje e varfërisë, dhe i urisë ushqim, ndreqje e shigurt' e mekatëve; o mjeku i shpërtheve, dhe i gjithë lengatave, ti o mesonjes, theollóg i doktrinave, ti që na shpjegón Testamentet e Shpirtit Shenjt; ligjë që çapet në caktón, kanún që na shpie drejt, o teorí dhe praktike, o urtesí pa kufí dhe funt. Iu-lut Jesú Krishtit, të na fale kurdoherë, meshirë dhe shpëtím.

Ti o pallát' i larë me ar, plot me virtuta, dhe zilí shenjterónjese, se ty të bënë banesë, si nonjë tempull qëllór, ty o At i Shenjtë Kryeprift i Math; se urtë dhe plot me ment, veperimet e ndjénjave, i qeverisë, edhe shpirtin e rúajte, si thesár të math, lark pësimeve çthúrese; pra si i par' i En-gjicjve, u-çfaqë o Shenjt i Math, o Kryeprift i bekuar, edhe kollona e Kísheve. Iu-lut Jesú Krishtit, të na fale kurdoherë, meshirë dhe shpëtím.

LAVDI DHE TANI, T. II. Zonjë Hyjlíndese, që línde Jesú Krishtin, për në pa prerë lutu, me Shen Joán Gojartin, o Nënë shpirtet na shpëtó.

NDËNJËSORET, T. T. IV, TIN SOFIAN

Urtësine prej qellit na e mësón, edhe hirin e Fjalës prej Zotit Krisht, të gjithëve u shkëlqén, dyke ndritur posi florí, edhe Trininë e Shenjtë, leçite posi njerí, edhe godite lakmimin me arkun e fjalëve. Pra si e qertove, mbretëreshen e prapë, u-dbove prej grigjes lark, u-mundove padrejtë-

sísht; o Gojartë peshkóp Joán, lutu-i Zotit Jesú Krisht, të na dhuronjë ndjesën e fájëve, neve që po ta lusim, ditën e shenjte besërisht.

LAVDI DHE TANI. Shpirtin tim të përunjur o Shen Marí, që në shqotën e jetës brënda në det, po rrihet prej éreve, dhe perpiqet prej vólave, edhe nga barr' e mekatit po mbytet prej újve, edhe në funt të Ferrit po kridhet taní me vrap; eja Virgjëreshë, dhe me lutjet e nxehta, shpëto me dhe shpërme shpejt, në limán dhe në qetesí; se me besë po të therrës: Lutu-i Birit Jesú Krisht, të na dhuronjë ndjesën e mekatave; se me ty kemi shpresë, gjithë të pavýerit.

T. III, THIAS PISTEOS

En' e qëllshime e Kishës sonë, bes' e pasurí e parcmbyer, u-tregove o Shen Joán o Kryeprift i Math, se jeten tendë e shkove me gas pa helm, dhe u ke dhënë meshirën këndonjesve. Atë Oshe-nár, iu-lut Perëndisë Jesú Krisht, tu fale shpërtheve, meshirë dhe shpëtím.

LAVDI DHE TANI, T. T. I,  
TON SINANARKHON

O luadhi i Fjalës dhe i Shkriptúrave, që na bënë të besojmë dhe të pendóhemi, që durove gjithë ngasjet e demóneve, në besniket o Shen Jan, dhe dishépujtë me mall siç duhet po të nderojmë, se lutesh përpara Zotit, për shpëtím të gjithë shpërtheve.

## T. IV, EPEFANIS

Me fjalime si florí, e ke vaditur, o Gojarte Shen Joán, Kishen e Shenjte per çudí, dhe çdo semundje na e sherón, neve qe lusim, te kremten e ndrícime.

## LAVDI DHE TANI, TON SINANARKHON

As Sinodi armík edhe i palígjeshme, as urrejtja e verber e pamejtúarshme, e mbretereshes dhe e gjithë kundreshtáreve, o Shen Joán s' te muntne dot, se si ari mun ne zjarr shkelqén dhe per né po lutesh, perpara Trinisë Shenjte, o At' o Kryepriфт i Math.

## SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalcrise, shume pasione me lftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartesohe ne paqesí, dhe ndrícohet prej njesise Trinisore mistikeríisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARÇVARGU. Goja ime do te flase urtesí, dhe zemra ime kupetím.

## UNGGJILLI I MËNGJJEZIT PAS JOANIT

Zoti u tha Judenjve, qe i kishin ardhur: "Me te vertete, me te vertete po ju them: Aý, qe nuke

hyn nga dera ne hoborrin e dhenve, po ngjitet gjétkazi, aý eshte vjedhes edhe kusár, edhe aý, qe hyn nga dera, aý eshte bariu i dhenve. Atí ia hap deren portari, dhe aý i therrét me emer dhente, dhe i nxier jashte. Dhe kur i nxier jashte dhente, barét perpara atyre, dhe dhente i vene pas, se ia njohin zerin. Se nuk i vene pas nje te húaji, po ikin prej tij, se nuk ua njohin zerin te húajve." Keté parabolle ua tha Jesúj, po nuk i múarne vesh ató, qe u thoshte. Jesúj, pra, u tha perserí: "Me te vertete, me te vertete po ju them se une jam dera e dhenve. Te gjithë atá, qe kane ardhur perpara meje, jane vjedhes edhe kusare, edhe dhente nuk i degjuan. Une jam dera. Aý, qe hyn me anen time, do te shpetonje, dhe do te hynje, dhe do te dale, dhe do te gjenje kullotje."

*Psalmi 51 pa ze.*

LAVDI. Me nermjetimet e Kryepriфтit, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

*Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.*

T. II. Si nje borí me ze, Ungjillin e buçite, dhe dhente i kullote, dhe grigjen e shpetove, nga Ferrri i demóneve.

## SHKURTORJA, T. T. II, TIN IPER IMON

Qe prej qellit lart, Joán o Shen Gojarte, more

hirin perëndór dhe na mesove, t' adhurojmë Trinine me një Perëndí, Oshenár dhe Patrík me nam, oratór i doktrínave, perandáj te lavderojmë sot, si mé te madhin profesór, per Perëndí dhe per Krisht.

### SHTËPIA

I përgjunjem Perendise, dhe i lutem Jesú Krishtit, edhe i kerkónj dhuratën e fjalës që ta lavderónj sipas vlerës Shen Joán Gojartin, Patrikun e math, edhe Mesónjesin Ekumeník, se aý ka qenë mé i madhi profesór per Perëndí dhe per Krisht.

### SINAKSARI

Me tetembedhjetë te ketí múaji, kujtojmë Shen Joanin, Gojartin, Atin tone dhe kryepeshkopin e Kostandinopojës.

Me nermjetimet e Gojartit, o Krisht Perëndí, meshirona dhe shpetona. Amín.

### ZBRITËSORET, T. IV, ANIKSO.

I. Ja gojen e çel taní, i frymësuar prej Shpirtit Shenjt, dhe kenge do t' i kendónj, Nenes se Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle buzeqeshur, me zë do t' i çpall kudó, gjithë çudit' e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendise, burím i pasosur jetësór, ti shiguroji gjith' atá, që te kendojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón, kurorezoi me çdo lavdí.

IV. Te pagjyrmesúarin pllan perëndór, që po misherohet i larti Zot prej Virgjërshes, Abakumi si Profét, e pá dhe tha me zë te math: Zot i fuqishim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me një çudí dhe një lavdí: Ti o Virgjërsh' e pamartuar, Zotin e jetës që mbreterón lart ne qell, si një bir e mbajte ne peqí dhe shpetím që lártazi, u dhurove besníkeve.

VI. Keté te kremte e lusim sot, per Zonjen edhe Nenen Hyjlíndese, gjithë hyjméndesit, eni trokisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin që lindi prej asáj.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjméndesit, po Krijetarit lart, dhe kercenimin me zjarr, e shkelnc me trimerí, psallnin me brohorí: Zot lavdí me ty, o Perëndí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Djemat e denuar per te djegur, prej zjarrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si simból ne vjeterí dhe si veperím taní, dhe tere boten po e mbleth per keng' e lavderím: Hymnójeni ju veprat e Zotit, dhe e lartsoni permi te gjitha jetet.

IX. Gjithë njërezit, keceni me ngazellím tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Çngjajt' e qellit eni kremtójeni, keté te shenjtc panair te Kryezonjes Marí, dhe therrisni: Ti je mé e lúmura, Virgjërsh' e kulluar Hyjlíndese.

## DERGIMSGORET, T. III, EPESKEPSATO

Me fjalime si florí, o Shen Joán Patrik me nam, e ndrite Kishen e Zotit Krisht, dhe ke gezuar çdo besnik, dhe na u-çfaqë si kasnéc, i besës Orthodoxe, dhe çpallës i dógmave.

Virgjereshe Hyjlíndese, o Nena e besnikëve, iu-lut përherë Zotit Krisht, për ndjesën e mekátave, tok me Gojartin Shen Joán, dhe falna dhe dhurona, Parajsen e Çngjcejve.

## LAVDERIMET, T. I, TON URANION

E imitove Shen Janin Profetin Pagezór, o Ate nga përmbajtja, dhe Ellinç Profetin, me kreshm' e agjerime dhe virgjëri, o Gojartë Shen Jan i Math, dhe i përbufe tiranët plot me kuxím, si barí i Shpëtimtarit Krisht.

I frymesuar për fjalës dhe për Shkriptúrave, ndërçove tërë botën, me mesimet e tua, o Ate Kryepërft Gojartë Shen Jan, çpallë qysh të pëndóhemi, dhe t' i kujtojmë të vërferit gjithënjé, pas Ungjillit të Zotit Krisht.

Me shpirt e zëmër të paqme dhe të panjóllshime, si yll e si një díell, i ndërçove besnikët, me dogmë Orthodoxe o Kryepërft, o Gojartë Shen Jan i Math, dhe trashëgove Parajsen përanc Jesújt, dhe kuroren e qíellit.

LAVDI, T. T. IV. Me fjalë të florinjta, dhe me predikime të përëndishme, e stolise Kishen e Përendisë, dhe ia rrite pasurite shpíterore. Përandáj po të sjellim sot, një kurorë për lulesh të pa-

físhkura, për kujtimin e nderuar, o Shen Joán i artë nga goja dhe nga shpírti, dhe të përënjur të lútemi: Nëmjetó përanc Krishtit, të shpëtohen shpírtet tona.

TANI. Për-i Hyjlíndese, lútjet e shërbetóreve, shpëtona gjithënjé, për rezíkeve dhe hidhërimi.

## SHKURTORJA, T. IV, O IPSOTHIS

I përëmpaqmi tëmpull i Shpëtimtarit, e përëmshejta nusçore e virgjër, dhe ark' e art' e ndërçime thesár' i Zotit Krisht, sot po sillet me lavdí, në shpëtin' e Përendisë, dhe hirin brenda po në sjell, plot me Frymën e Shenjtë, për e hymnojne Çngjajtë me brohorí: Kjo ketú është, banesa e qéllshime.

## APOSTULLI

Goja ime do të flasë urtesí. Dëgjójini ketó, të gjithë kombët.

Për Letres së Palit për Hebrenjtë.

Vëllezër, një Kryepërft i ketille në duhej, i drejtë, i mirë, i paqme, i larguar për mekátarëve, dhe më i lartë se qelli, i cili nukë ka nevojë, si kryepërfterinjtë e tjerë, të blatonjë therorë më parë për mekátat e veta dhe pastáj për ató të pópullit, se keté e bëri një herë, kur e blatój veten e tij. Se ligja i bën kryepërfter njëçzít, që kanë dobësira, po fjala e besë pas ligjës e bën Birin të mbaruar për jetë. Me paqë fjalë, kemi një Krye-

prift te ketille, i cili ndenji me te djathten e fronit te madheshtise ne qell, nje meshetar te shenjterores dhe te tabernakullit te vertete, te cilen e ka ngritur Zoti dhe jo njeriu.

### UNGGJILLI PAS JOANIT

Zoti tha: Une jam dera. Aý, qe hyn me anen time, do te shpetonje, dhe do te hynje, dhe do te dale, dhe do te gjenje kullotje. Kusari nuke vjen veçse per te vjedhur, per te therrur dhe per te humbur, po une kam ardhur qe tju jap jete dhe tju jap jete te teper. Une jam bariu i mire. Bariu i mire ve shpirtin per dhente. Po rogetari, i cili nuk eshte barí, dhe nuk i ka te tija dhente, e sheh ujkun, qe vjen, edhe i le dhente, dhe iken, dhe ujku i rembén, edhe i çkaterrón dhente. Dhe rogetari iken, se eshte rogetár, dhe nuk e ha malli per dhente. Une jam bariu i mire, dhe i njoh te miat, edhe te miat me njohin. Sikunder me njeh im Ate, edhe une e njoh Atin, edhe ve shpirtin per dhente. Kam edhe dhen te tjera, qe nuke jane prej keti haborri, edhe duhet t' i siell edhe ató; edhe do ma degjojne zerin, edhe do te behen nje kopé dhe nje barí.

### KUNGATORJA

I drejti do te kujtohet per jete.

14. *Shen Filipi.*

PERLESHORJA E SHEN FILIPIT, T. III.

Filip Apostull i Shenjte, lutju Zotit tone Jesú

Krisht, tu fale shpírteve tona, ndjesen e mekátave.

### THIRRTORET, T. T. II, OLIN APOTHEMENI

Veprën ti e quájte, zbatimin e theorise, teoriere nje drejtím, per nje veprim te krishtere edhe besnik; edhe gjete Zotin Krisht, qe ta çfaqí Zotin, Mbreterine e Shenjtóreve, se cilidó mi dhé, di logjikerisht Atin Perendí, qe beri dhen' e qiéllin, dhe çdo gje e more qe kishe mall; per ketó te gjitha, pasqyre kishe Zotin Krisht, pra nermjetó per te gjithë né, dhe shpirtet na i shpetó.

Hipe shpírterisht ne qell, si Moisiu Profeti, qe re mal Siná u-ngjit, Zotin Perendí ta shikonje lishc mall; dhe me sy ti e pé, si me nje pasqyre, shembellsín' e tij te qëllshime; se Biri doemós, eshte si dhe Ati dhe Shpirti Shenjt; dhe jane qe te dy nje soj, nje qe nga substanca e hýjeshme; edhe ner te gjitha, njesí' e tyre çfaqet ploterisht, ne Mbreterín' e perjétslime, tok me gjithë Engjejte.

Si orgán dhe instrumént, i frymesuar prej qellit, dyke patur Shpirtin Shenjt, si nje udhëheqes te mellodírave; Ungjillin e Zotit Krisht, predikón ne bote, dhe ndrìqove te mesúarit, me gjuhe flag' e zjarr, dogje prapesít' e pagáneve; si kasht' e vrah e si gerdhú, dhe si bar te djegur prej díellit; edhe Perendine, dhe Zotin Shpetimtarin Jesú Krisht, ua leçite besnikëve, o Shen Apostull Filip.

LAVDI DHE TANI, T. II. Driten prej Díellit,

o Shen Filíp e more, edhe mi dhé shkelqeve, dhe njërezit i ndrite, o Apostúll i Zotit Krisht.

PASVARGJET, T. T. IV, O TU PARADHOKSU

Ç' është kjo çudí dhe kjo habí! Aý qe ish peshkatár, na u-çfaq Apostúll taní, dhe gjahtar i njëresve, peshkatari i qíellit; me rjete fjalesh, kombet i ze si pishq; me tonje Kryqi, boten perpjét' e heq. Oh ç' fare gjah te math, na i solli Zotit Krisht ky Shenjt i Math! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

Ç' është kjo çudí dhe kjo habí! Na e dergój Zot' i Math, Shen Filipin prej qíellit, dele midis új-qerve, po aý nuk u-tremp aspák, bishat i beri, shqerra me bes' e fe; boten e tere, me predikím e ndroj. Sa vepra pa tregím, na ke ber' o Apostúll i Zotit Krisht! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

Ç' është kjo çudí dhe kjo habí! Si pus per né po burón, uj' e vala me urtesí, per te gjithë njërezit, Apostulli i Zotit Krisht; prej tij doktrinát, rjedhin posi luménj, hir dhe shërime, kunder lengátave. Sa vepra me lavdí, dhe çudí ke bere ti o Shen Filíp! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

LAVDI DHE TANI, T. II. Boten me vrap e lé, dhe Krishtit pas i vajte, dhe njërezit i ktheve, me driten e Ungjillit, Filíp dhe vdiqe si Deshmór.

NDENJCSORET, T. T. IV, TIN SOFIAN

Po i ndjek djajt' e zes dhe i çkaterrón, dhe sa

jan' erresuar, ti i ndriçón, se Díellin ti u çfaq, prej Marise Hyjlíndese; edhe Kishet pagane i çthure perfundërisht, edhe Kishë Orthodokse ndertove per Zotin Krisht; ty pra t' adhurojme, dhe me mall te hymnojme, me buj' e me brohorí, dhe therrsim me ze te math: I Shenjt' Apostull Filíp, lutu-i Zotit Jesú Krisht, te na dhuronje ndjesen e mekátave, neve qe po kremtojme, besërisht kujtimin tent.

LAVDI DHE TANI. Shpirtin tim te perunjur o Shen Marí, qe me shqoten e jetes brenda ne det, po rrihet prej éreve, dhe perpiqet prej vólave, edhe nga barr' e mekatit, po mbytet prej újeve, edhe ne funt te Ferrit po kridhet taní me vrap; eja Virgjereshe, dhe me lutjet e nxehta, shpetome dhe shpjerme shpejt, ne limán dhe ne qetesí; se me besë po te therrés: Lutu-i Birit Jesú Krisht, te na dhuronje ndjesen e mekátave, se me ty kemi shprese, gjithë te pavýerit.

*Meqéneqe nuke ka Ungjill te Mengjezit, kendohet menjehere:*

SHKURTORJA, T. T. IV, OS APARKHAS

Shen Apostulli shoku yt, imitatór' i vójtjeve, te proklamój kudó si Perendí dhe Zot, o Shpetimtár o Jesú Krisht. Pra aý po te lutet, ta shpetósh Kishen tende, prej kundërshtáreve, te liq me nermjetimet e Zonjes sone Hyjlíndese.

SHTËPIA

Fal-me valat e fjales, forcoma zemren, dhe

ndritma mendjen, o Zot i zemërdhempshur, që ta lavderónj sipas vlerës Dishépullin e degjuar dhe Apostullin Shen Filíp, me nermjetimet e Zonjes sonë Hyjlíndese.

### SINAKSARI

Me katermbedhjetë të ketí múaji, kujtojmë Shen Filipin, Apostullin e lavderuar dhe emërshkelqyer prej të Dymbëdhjeteve.

Me nermjetimet e tij, o Perendí, meshirona dhe shpëtona. Amín.

### ZBRITËSORET, T. IV, ANIKSO

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpirtit Shenjt, dhe kengë do t' i këndonj, Nenes së Madhe mi fron, dhe do ta kremtonj, me valle buzëqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithë çudit' e saj.

III. O Zonjë dhe Nën' e Perëndisë, burím i pasosur jetësór, ti shiguroji gjith' atá, që të këndojnë plot me zell, dhe lart në qell ku mbreterón, kurorëzoji me çdo lavdí.

IV. Të pagjyrmesúarin pllan perendór, që po misherohet i larti Zot prej Virgjërshes, Abakumi si Profét, e pá dhe tha me ze të math: Zot i fuqishim lavdí me ty.

V. Të gjith' i habite ti, me një çudí dhe një lavdí: Ti o Virgjërsh' e pamartuar, Zotin e jetës që mbreterón lart në qell, si një bir e mbajte në peqí dhe shpëtím që lartazi, u dhurove besníkeve.

VI. Keté të kremte e lusim sot, për Zonjen e-

dhe Nenen Hyjlíndese, gjithë hyjmëndesit, eni trokisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin që lindi prej asáj.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjmëndesit, po Krijetarit lart, dhe kërcenimin me zjarr, e shkelnë me trimëri, psallnin me brohorí: Zot lavdí me ty, o Perendí i Aterve, ti je vetëm i bekuar.

VIII. Djemat e denuar për të djegur, prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit Krisht, si simból në vjetëri, dhe si veperím taní, dhe tërc botën po e mbleth për këng' e lavderím: Hymnójëni ju veprat e Zotit, dhe e lartësoni përmi të gjitha jetët.

IX. Gjithë njërezit, këceni me ngazellím tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójëni, Çngjëjt' e qellit eni kremtójëni, keté të shenjtë panair të Kryezonjes Marí, dhe thërrisni: Ti je më e lúmura, Virgjërsh' e kulluar Hyjlíndese.

### DËRGIMËSORET, T. III, EPESKEPSATO.

More hir prej Shpirtit Shenjt, o Shen Filíp o Apostúll, edhe Ungjillin e Jesújt, e çpalle midis kómbeve. Pra nermjetó përpara tij, që të na dhuronjë, Parajsën e Çngjëjve.

O Marí Hyjlíndese, nermjetó pranë Birit tënt, tok me Dishépullin Filíp, që të na mpronjë gjithënjé, dhe tu dhuronjë përdellím, shpëtím edhe meshirë, të gjithë besníkeve.

## LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Mi tere dhen' u-degjua nami yt o Filíp, o Apostull i lumur, qe perhape Ungjillin, dhe dogmen orthodoxe qe na leçit, Atin Birin dhe Shpirtin Shenjt, qe adhurojme te gjithë mistikerisht, si Triní te bashkeqénshime.

Si Apostullin e pare te Zotit Jesú Krisht, edhe si yll te ndriçim, t' orizontit te Kishes, te quajme te gjithë o Shen Filíp, dhe nga shpirti ndriçohemi, se nermjetón dhe na fal gjithënjé shpetim, e dhe ndjese te mekátave.

E more Kryqin mi supet, si na tha Zoti Krisht, dhe dolle faqebardhe, dhe fitove kuroren, me djers' e me mundime o Shen Filíp, dhe keshtú trashegón ne qell, Parajsen tok me Shenjtoret dhe nermjetón, per shpetimin e besnikëve.

LAVDI, T. II. O Apostull Filíp, me lule predikimesh, e mbolle Krishterimin, dhe mblet' e mjalte mblodhe, ne Kishet me Ungjillin tent.

TANI. Çdo shprese mi ty e varr, Marí o Hyjlíndese, Nen' e Zotit Krisht, ti me ruaj perhér' e ti me mpro.

## SHKURTORJA, T. IV, O IPSOTHIS

I permipaqmi Tempull i Shpetimtarit, e permishenjta nuscrore e virgjër, dhe ark' e art' e ndriçime thesár' i Zotit Krisht, sot po sillet me lavdí, ne shtepín' e Perendise, dhe hirin brenda po na sjell, plot me Frymen e Shenjte, pra e hymnojne

Engjejte me brohorí: Kjo ketú eshte, banesa e qëllshime.

## APOSTULLI

Fama e tij u-perháp ne tere boten. Qelli tregón lavdine e Perendise.

Prej Akteve te Apostujve.

M' ató dite, Engjelli i Zotit i foli Filipit, edhe i tha: "Ngrehu, dhe shko nga juga ne udhen, qe zbret nga Jerusalemi ne Gazen, e cila eshte ne shkretetire." Dhe aý u-ngrit, edhe vajti, dhe ja ku nje hadém Ethióp, nje zyrtár i Kandakes, mbretreshes se Ethiópeve, i cili e qeveriste tere Gazen, edhe kishte ardhur qe te falej ne Jerusaleém, edhe taní po kthehej, edhe rrinte mi qeren, edhe kendonte Isaine. Edhe Shpirti i Shenjte i tha Filipit: "Shko, edhe ngjitu pas asáj qereje." Dhe Filipi rendi, dhe e degjój qe po kendonte Isaine, dhe i tha: "Valle a i merr vesh ató, qe po kendón?" Dhe aý iu-pergjéq: "Si do te munt, kur nuke kam njerí qe te mi shpjegonje?" Dhe iu-lut Filipit qe te hipte, dhe te rrinte prane tij. Edhe pjesa e Shkriptures, te cilen e kendonte, ishte kjo: "Si dele u-hoq ne therje, dhe si shqerre nuk e hapi gojen kunder atí qe e qethte. E humbi gjykimin nga poshterimi. Edhe kush do te flase per brezin e tij? Se jeta e tij po rembehet prej dheut." Edhe hademi e pyeti Filipin: "Te lutem, thua-me per ke i thote ketó Profeti? Per veten e tij apo per nonjë tjater?" Dhe Filipi e çeli gojen, dhe nisi

nga ajó Shkripturë, dhe ia predikój Krishtin. Dhe tek po shkonin udhës, arrinë me një uje, dhe hademi tha: “Ja uje. Ç’ me ndalón te pagëzohem?” Dhe Filipi i tha: “Nëqóftëse besón me tërë zemrën, munt ta bëjmë.” Dhe aý u-përgjéq: “Besónj se Jesú Krishti është i Biri i Perëndisë.” Dhe urdherój që të qëndronte qerja; dhe zbritne në ujën që të dy, Filipi dhe hademi, dhe e pagëzój. Edhe kur dúallne nga uja, Shpirti i Shenjtë e rëmbeu Filipin, dhe hademi nuk e pá mé, edhe vazhdój udhën i gezuar.

#### UNGJILLI PAS JOANIT

M’ até kohë, Jesúj deshi të shkente në Galilé; edhe e gjeti Filipin, dhe i tha: “Eja pas meje.” Dhe Filipi ishte nga Bethsaida, qyteti i Andeut edhe i Pjetrit. Filipi e gjeti Nathanielin, edhe i tha: “E gjeta Jesunë, të birin e Josefít nga Nazareti, për të cilin kanë shkruar në ligjë Moisiu dhe Profetet.” Edhe Nathanieli i tha: “A munt të vinjë nonjë e mirë nga Nazareti?” Dhe Filipi iu-përgjéq: “Eja dhe shih.” Edhe Jesúj e pá Nathanielin, që i vinte, dhe tha për até. “Ja një Israelít i fjeshtë pa djallëzí.” Dhe Nathanieli i tha: “Që ngá me njëh?” Edhe Jesúj iu-përgjéq: “Përpara se të të therriste Filipi, të pashe që ishe nënë fikun.” Edhe Nathanieli i tha: “O Zot, ti je i Biri i Perëndisë, ti je Mbreti i Israelit.” Edhe Jesúj iu-përgjéq: “Se të thashe që të pashe nënë fikun, me besove? Do të shikósh gjëra mé të mëdhá se kjo.”

Edhe pastáj i tha: “Që taní e tutje do të shikósh qellin të hapet, edhe Engjëjt’ e Perëndisë të hipin e të zbresin mi të Birin e njeriut.”

#### KUNGATORJA

Fama e tij u-përháp në tërë botën.

15. *Guria, Samonáj dhe Habibi, Deshmoret e Shenjte.*

16. *Shen Matheu Ungjillori.*

#### PERLESHORJA E SHËN MATHEUT, T. III.

Shen Matthé Apostúll dhe Ungjillór, lutju Zotit tonë Jesú Krisht, tu falë shpírteve tona, ndjeshen e mëkátave.

#### THIRRTORET, T. T. IV, TI IMAS.

Si të të levdojmë o Apostúll? Si një qell që na tregove, çdo lavdí të Zotit Krisht; shkrepëtím që e shkelqeve, tërë botën me ndriçím; si re e cila derdhi shi prej qiellit; si enë plot me verë të çudíqime, që u jep dëfrím dhe urtesí, zëmrave dhe gjithë shpírteve. Të lútemi, nermjetó për né dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostúll? Si një lumë të Parajsës, që na rjeth e na vadít, si një arke me një dhjatë, që na fali Zoti Krisht; si díell shpírterór që na ndriçón me gas; si dritë që shkelqén në mes të Kísheve; Buk’ e Shenjtë e Alltáreve, Kup’ e Kungatës së Shpirtit Shenjt. Të lútemi, nermjetó për né dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostúll? Meshetár për sakramentat, perëndore të Jesújt; themeltár i Kri-

shterimit, qe ne Kishen predikón; qe pllakat ke latuar te kumándave, qe ligjen ke perhapur, dhe nje hir te ri, qe nga Sión' e Proféteve, e prokllamove o Ungjillór. Te lútemi, nermjetó per né dhe na shpetó.

Si te te levdojme o Apostúll? Si thesár prej pasurirash, te panúmerta ne qell; a si mjek dhe si sheronjes, per çdo zemer dhe çdo shpirt; si shokun e patundur dhe leçitesin, e dógmave te mirclajmerúara; tituj ke te shum' o Shen Matthé, dhe je nje pus i virtútave. Te lútemi, nermjetó per né dhe na shpetó.

Si te te levdojme o Apostúll? Si Dishepull qe leçite, Shpetimtarin Jesú Krisht; si mjek qe pasionet, i sherón per çdo besnik; si diell shpirterór qe na ndriçón me gas; kollone dhe themél i gjithë Kísheve; ti qe na e shkrove o Matthé, Ungjillin e Zotit Jesú Krisht. Te lútemi, nermjetó per né dhe na shpetó.

Si te te levdojme o Apostúll? Meshetár i urtesise, i vertete dhe besnik, ti na shkrove na leçite, çdo mesím e porrosí, kollón' e gjithë Kísheve te Zotit Krisht, keshtjéll' e patronditur e besnikeve. Te shuma dhe te panúmerta, dhuratat e doktrinave. Te lútemi, nermjetó per né dhe na shpetó.

LAVDI DHE TANI, T. II. Driten prej Díellit, o Shen Matthé e more, edhe mi dhé shkelqeve, dhe njérezit i ndrite, o Ungjillór i Zotit Krisht.

PASVARGJET, T. T. IV, O TU PARADHOKSU

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Aý qe ish pub-

likán, na u-çfaq Apostúll i math, Ungjillór i kísheve, shpetimtar i njéresve, me predikime, kombet i kthen ne fe, me tonje Kryqi, boten perpjét' e ngre. Oh ç' fare gjah te math, na i solli Zotit Krisht, ky Shenjt i Math! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Na e dergój Zot' i Math, Shen Matthene prej qiellit, dele midis új-qerve, po aý nuk u-tremp aspák, bishat i beri, shqerra me bes' e fe; boten e tere, me predikim e ndroj. Sa vepra pa tregím, na ke ber' o Ungjillór i Zotit Krisht! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Si pus per né po burón, uj' e vala me urtesí, per te gjithë njérezit, Ungjillori i Zotit Krisht. Prej tij doktrinat, rjedhin posi luménj, hir dhe shcrime, kunder lengátave. Sa vepra me lavdí, dhe çudí ke bere ti o Shen Matthé! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

LAVDI DHE TANI, T. II. Boten me vrap e lé, dhe Krishtit pas i vajte, dhe njérezit i ktheve, me driten e Ungjillit, Matthé o Ungjillór i Math.

NDENJGSORET, T. I, TON TAFON SU

I pari Apostúll, qe ke shkruar Ungjillin, dhe boten e ndriçón me mesimet e tua, Matthé i Shenjt Apostúll, dhe dishépull i Zotit Krisht, te nderojme pra, me hymne dhe melodira, dhe te lútemi, qe te na falen mekátat, te gjithë besnikeve.

## LAVDI, T. T. IV, TIN SOFIAN

Neverite floririn me te vertét, edhe Krishtin pasove vullnetarisht, i Shenjte Apostull Matthé, tere boten po e ndriçon, dhe ti qe ishe publikan u bere dishépulli, dhe ungjillór i degjuar i fjales se Zotit Krisht. Sot pra jemi mbledhur, dhe me mall te nderojme, me buj' e me brohorí, dhe me kenge levdónjese, dhe therresim me ze te math: I Shenjt Ungjillór Matthé, lutu-i Zotit Jesú Krisht, te na dhuronje ndjesen e mekátave, neve qe po kremtojme, bescrisht kujtimin tent.

TANI. Ti o porte qellore o Shen Marí, ti o mali i shenjte plot me shkelqím, o re udhéhéqese, ti o shkalla e qëllshime, ti o Parajs' e méndeshme per Even shpetónjese, ti o thesár i botes, i shtrenjte i çmúarshim; ti o Nen' e Shenjte, ti shpetimin na solle, nga fajet e prínderve, dhe mallkimet e gjýsherve. Perandáj te therresim: Nermjetó pranë Birit tent, qe tu dhuronje ndjesen e mekátave, te gjith' atyre qe lusin, lindjen tende te hýjeshme.

*Meqéneqe nuke ka Ungjill te Mengjazit, kendohet menjehere:*

## SHKURTORJA, T. IV, O IPSOTHIS

E hodhe tutje terezín' e doganes, dhe nene zgjedhen e se drejtes u-lidhe, dhe u-tregove tregtar i shenjte me ment, mblodhe pasurí ne qell, dhe thesár urtesie, dhe leçite plot me zell, predikimin e Krishtit, edhe u prure njéresve shpetím, se trasheguan, Parajsen e Çngjcejve.

## SHTEPIA

Shpetome nga tirania e armikut te pangopur, qe ma shkretójt shpirtin, dhe ma rembeu faren e mire, o Ungjillór Shen Matthé, o mik edhe dishepull i Shpetimtarit, se ti leçite plot me zell predikimin e Krishtit, edhe u prure njéresve shpetím, dhe trasheguan Parajsen e Çngjcejve.

## SINAKSARI

Me gjashtembedhjete te ketí múaji, kujtojme Shen Matthens, Ungjillorin dhe Apostullin e lavderuar dhe emershkelqyer prej te Dymbedhjetëve.

Me nermjetimet e tij, o Perendí, meshirona. Amín.

## ZBRITËSORET, T. IV, ANIKSO

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpirtit Shenjt, dhe kenge do t' i kendónj, Nenes se Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle buzcqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithë çudit' e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendise, burím i pasosur jetesór, ti shiguroji gjith' atá, qe te kendojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón, kurorezoi me çdo lavdí.

IV. Te pagjyrmesúarin pllan perendór, qe po misherohet-i larti Zot prej Virgjereshes, Abakumi si Profét, e pá dhe tha me ze te math: Zot i fuqishim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje lavdí: Ti o Virgjerësh' e pamartuar, Zotin e jetes qe mbretëron lart ne qell, si nje bir e mbajte ne peqí dhe shpetím qe lártazi, u dhurove besnikëve.

VI. Keté te kremte e lusim sot, per Zonjen e dhe Nenen Hyjlíndese, gjithë hyjméndesit, eni trokisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin qe lindi prej asáj.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjméndesit, po Krijetarit lart, dhe kerçenimin me zjarr, e shkelne me trimerí, psallnin me brohorí: Zot lavdí me ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Djemat e denuar per te djegur, prej zjarrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si simból ne vjetëri, dhe si veperím taní, dhe tere boten po e mbleth per keng' e lavderím: Hymnójeni ju veprat e Zotit, dhe e lartësoni permi te gjitha jetet.

IX. Gjithë njërezit, keçeni me ngazellím tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Çngjçjt' e qellit eni kremtójeni, keté te shenjtc panair te Kryezonjcs Marí, dhe therrisni: Ti je mé e lúmura, Virgjerësh' e kulluar Hyjlíndese.

#### DERGIMCSORET, T. III, EPESKEPSATO

Terezine me florí, e hodhe tej dhe Kryqin tent, e more dhe i vajte pas, Jesújt o Shen Matthé me nam; dhe Mbretërine me lavdí, dhe ndere trashegove, o Shenjt Ungjillór i Math.

O Marí Hyjlíndese, nermjetó pranë Birit tent,

tok me Matthene Ungjillór, qe te na mpronje gjithënjé, dhe tu dhuronje perdellím, shpetím e dhe meshire, te gjithë besnikëve.

#### LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Mi tere dhen' u-degjua nami yt o Matthé, o Apostúll i lumur, qe perhape Ungjillin, dhe dogmen Orthodokse qe na leçit, Atin Birin dhe Shpirtin Shenjt, qe adhurojme te gjithë mistikerisht, si Triní te bashkeqénshime.

Si Ungjillorin e pare te Zotit Jesú Krisht, edhe si yll te ndriçim, t' orizontit te kishes, te quajme te gjithë o Shen Matthé, dhe nga shpirti ndriçohemi, se nermjetón dhe na fal gjithënjé shpetím, edhe ndjese te mekátave.

E more Kryqin mi supet, si na tha Zoti Krisht, dhe dolle faqebardhe, dhe fitove kuroren, me djers' e me mundime o Shen Matthé, dhe keshtú trashëgón ne qell, Parajsen tok me Shenjtoret dhe nermjetón, per shpetimin e besnikëve.

LAVDI, T. II. O Ungjillór Matthé, me lule predikimesh, e mbolle Krishterimin, dhe mblet' e mjalte mblodhe, ne Kishet me Ungjillin tent.

TANI. Çdo shprese mi ty e varr, Marí o Hyjlíndese, Nen' e Zotit Krisht, ti me ruaj perhér' e ti me mpro.

#### SHKURTORJA, T. IV, O IPSOTHIS

I permipaqmi Tempull i Shpetimtarit, e permi-shenjta nuserore e virgjer, dhe ark' e art' e ndrí-

çime thesár' i Zotit Krisht, sot po sillet me lavdí, ne shtepín' e Perendise, dhe hirin brenda po na sjell, plot me Frymen e Shenjte, pra e hymnojne Engjejte me brohorí: Kjo ketú eshte, banesa e qëllshime.

### APOSTULLI

Fama e tij u-perháp ne tere boten. Qelli tregón lavdine e Perendise.

Prej Letres I se Palit per Korinthianet.

Vellezer, Perendia na çfaqí né Apostujte si te funtme ne vdekje e sipër, se u-beme theater per boten edhe per Engjejte edhe per njërczit. Né te marre per Krishtin, dhe ju te mençim me Krish-tin; né te dobet, edhe ju te forte; ju te lavderuar, edhe né te çnderuar. Edhe gjer ne oren e tanish-me kemi urí edhe etje, edhe jemi te çveshur edhe te rrahur edhe te arratisur edhe te munduar, dy-ke punuar me dúarte tona; kur sháhemi, bekoj-me; kur ndíqemi, durojme; kur poshteróhemi, fá-lemi; jemi bere si gatrát e botes edhe si plehet e te gjithëve gjer taní. Nuk jua shkruanj ketó qe tju turperónj, po qe tju keshillónj si bijt' e mi te dashur. Se munt te kini dhjete mije mesonjes, po nuke kini shume ater; se une ju kam lindur me Jesú Krishtin me anen e Ungjillit. Ju lutem, pra, béhuni imitatoret e mi.

### UNGJILLI PAS MATTHEUT

M' até kohe, Jesú tek po shkonte, pá ne zyren e doganes nje njerí, te quájtur Matthé, edhe i tha:

“Eja pas meje.” Dhe aý u-ngrit, edhe i vajti pas. Edhe kur u-shtrua per te ngrene ne shtepí, ja ku arthne shume publikane dhe mekatare, edhe u-shtruan ne sofer bashke me Jesune dhe me Di-shépujt' e tij. Edhe kur e pane Farisianet, u tho-shin Dishépujve: “Persé Mesónjesi juaj ha dhe pi me publikanet edhe mekataret?” Edhe kur e degjój, Jesú u tha: “Nuke kane nevojë per mje-kun te shendoshet po te semuret. Shkoni, edhe mesoni ç' kupetím kane fjalet e Shkriptures: Dua meshire dhe jo therore. Se nuke kam ardhur te therrés per pendím te drejtet, po mekataret.”

### KUNGATORJA

Fama e tij u-perháp ne tere boten.

17. *Grigori Çudibéresi., Ati yne i Shenjte, peshkopi i Neokesarise.*

### PERLGSHORJA E GRIGORIT TE NEOKESARISE, T. T. IV.

Me lutje dhe nermjetím, dhe me shcrime dhe me çudí te paréshtura, fitove fame te madhe te merituarshme. Pra lutju Zotit Krisht Perendí Ate Grigór ne qell, t' i ndrite shpirtet tona, qe te mos na zere gjumi i mekatit per vdekje.

18. *Platoni dhe Romani, Deshmoret e Shenjte.*

19. *Abdiu, Profeti i Shenjte; Varlaani, Deshmori i Shenjte.*

20. *Vengjilla e Hyrjes se Shen Marise ne Kishe; Grigori Dekapoliti, Ati yne i Shenjte; Prokli, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Kostandinopojes.*

PERLESHORJA E GRIGORIT DEKAPOLITIT,  
T. IV.

O Perendí i Aterve, qe na sillesh gjithenjë, me miresí dhe butesí, mos e kursé perdellimin tent per né; me lutjet e Aterve tanc, qeveris-e <sup>2</sup> ten tone me paqe.

21. *Hyrja e Shen Marise.*

PERLESHORJA E HYRJES, T. IV.

Sot eshte parenisja e mirepelqimit te Perendise, dhe parelçitja e shpctimit te njéresve; ne Kishen e Perendise, tregohet Virgjeresha madherisht, edhe Krishtin u parelajmerón te gjithëve; asáj edhe né le t' i therresim me ze te math: Gezohu o mbarím i urdherimit te Krijetarit.

THIRRTORET, T. I, TON URANION

Le te kecéjm' o besnikë me psallm' e hymne sot, le ta kendojme Zotin, dhe Marín' e bekuar, se hyri sot n' alltarin plot me lavdí, qe te rritet ne témpullin, dhe Zaharia e priti si kryeprift, me gezím dhe me brohorí.

Sot Virgjeresha dhe Zonja Nena e Zotit Krisht, ner grate e bekuar, hyn ne tempull te shenjtc, dhe prínderit e saj kremtojne me gas, Joakimi dhe Anna tok, dhe virgjereshat kecejne me brohorí, dhe hymnojne Hyjlíndesen.

Te lajmeruan Profetet Zonje Hyjlíndese, dhe Apostújt' e Shenjte, dhe Deshmoret te mburrne, besniket te hymnojne me brohorí, dhe lavdí si

perlíndese, se nermjetón gjithenjë dhe na fal shpetím, edhe ndjesen e mekátave.

LAVDI DHE TANI, T. II. Zoti buke te jep, ne Témpullin e Shenjte, me duar engjellore, dhe e. belsí qellore, si Zonje dhe Hyjlíndese.

LASVARGJET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Gas mbreterón ne qell dhe mi dhé, se qell' i Shpirtit, po hyn brenda ne témpullin, ne Kishen e Perendise, qe te stervitet me zell, Virgjérsh' e vetem e panjollshime; asáj sot po i therrét, Zaharia Profét' i math: Der' e te Lartit, ja per ty qellen dýerte, eja hyr me gas, edhe reth e perqárk besé; sot mora vesh dhe po besónj, shpetimi po vien per né, edhe per ter' Israelin, se Fjal' e Zotit prej teje lint, Jesúj Shpetimtari, dhe ay i dhurón hotes, meshire dhe shpetím.

Anna e Shenjte sot po e sjell, vajzen hirplote, Virgjereshen Hyjlíndese, ne Kishen e Perendise, me gas dhe me ngazellím, dyke patur vajza paravájtese, llambadhe te ndézura, dyke mbajtur ne dúarte, edhe i thoshte: Shko perpara krijónjesit, si nje mblat' e re, si kurbán edhe si temján. Shko brenda hyr ne témpullin, n' alltarin e bréndeshme, edhe mesoji misteret ti o banesc e Zotit Krisht, qe ardhí ne bote, tu dhuronje njerezise, meshire dhe shpetím

Hyre ne Kishen e Shen Marí, dhe u-blatove si nje tempull i Zotit Krisht, o Nene dhe Virgjereshe, dhe me llambadhe taní, te percjellin vajza

driteprurcse. Kecejne nga gazi, çift' i shenjt' i Hyjprinderve, Shen Joakimi, dhe Shen Anna gezohen sot, se krijónjcsin bij' e tyre Marí po lint; kjo po kecén perqárk taní, perbrenda ne témpullin, edhe ushqehet me doren, e Perendise dhe Engjejve, si nena e Krishtit, qe i fali njerezise, meshire dhe shpetím.

LAVDI DHE TANI, T. II. Vajza me brohorí, percillni Virgjereshen, me kenge dhe llambadhe, ne Témpullin si nuse, n' Alltarin e te Shénjtave.

#### NDENJCSORET, T. I, TON TAFON SU

Te drejtet prinder ke, Joakimin dhe Annen, dhe vjen ne Kische sot, si dhurate per Zotin, e vogel nga versa je, ti qe jet' e ushqím na jep, ty po te bekón, Profeti plak Zaharia; pra te gjithë né, o Nen' e Zotit dhe Mbretit, me besë te fálemi.

#### T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Sa pa lindur o Marí, per Perendine dhuretí, posa linde permi dhé, sipas zotimit prinderór, ushpure menjchere perpara Zotit. Ne témpullin e math, Tempull i Zotit Krisht, si foshnje pa nje cen, midis llambádheve shkelqén, si nje kandíl i drites se paafrúarshme. E madhe eshte, e kremtja jote, o Virgjereshe Hyjlíndese.

#### T. T. IV, TO PROSTAKTHEN

Le te gezohet hymnografi Shen Davidi, le te kecejne Joakimi tok me Annen, se nje bij' e shenjte prej atyre lindi. Maria, si nje llambadhe

sot po shkelqén; ne tempull, sot e gezuar hyn me lavdí, dhe até e bekój me mall. Profét' i math Zaharí, dhe thirri edhe tha me gas: Drit' e botes lavdí me ty.

#### SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartsohet ne paqesi, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARCVARGU. Unj-e veshin dhe degjó, shikó dhe harroje pópullin tent, edhe shtepín' e atit tent, se mbreti ra ne dashurí me bukurine tende.

#### UNGJILLI I MËNGJJEZIT PAS LUKAJT

M' ató dite, Mariama u-ngrit, dhe vajti me nxitím ne malesí, ne nje qytét te Judese, dhe hyri ne shtepine e Zaharise, dhe e pershendoshi Elisabeten. Dhe posá e degjój Elisabeta pershendoshjen e Marise, keceu foshnja ne barkun e saj. Dhe Elisabeta, e frymesuar prej Shpirtit te Shenjte, thirri me ze te math, edhe tha: "E bekuar je ti ne mes te grave, dhe e bekuar eshte pema e barkut tent. Dhe si me ngjau kjo lumerí, qe e-jema e tim-

Zoti te me vizitonje? Se ja, posa me tingelliu ne veshet pershendoshja jote, me keceu foshnja ne barkun me ngazellim. Dhe lum' ajó, qe ka besuar, se do te permbushen fjalet, qe jane thene prej Zotit per até." Dhe Mariama tha: "Madheshtoje Zotin, o shpirti im, edhe ti, o mendja ime, ngazellohu mi Perendine, Shpetimtarn tim; se e hodhi syrin mi sherbetoren e perunjur; se ja qe-tani e tutje gjithë brezat do me lumerojne; se me madheshtóji i Fuqishmi, dhe emri i tij esht' i shenj-te." Dhe mbeti Mariama bashke me até nja tre muaj, dhe pastáj u-kthye ne shtepine e vete.

*Psalmi 51 pa ze.*

LAVDI, T. II. Sot Zonja Shen Marí, ne Témpullin si Tempull, i Shpetimtarit tone, po hyn per te banuar, o popuj pra gezóhuni.

TANI. *Gjithajó.*

*Meshirome, o Perendi meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.*

T. II. Sot vete Témpullin, e Krishtit Perendise, e priti Zaharia, ne Shenjterore brenda, o Engjej lavderójeni.

### SHKURTORJA, T. IV, O IPSOTHIS

*Kjo Shkurtore kendohet ne Meshen pas Hyrjes se Vogel qe me 8 te Nentorit gjer me 25 te Nentorit. Pas kesáj date kendohet Shkurtorja e Kershendéllave.*

I permipaqmi Tempull i Shpetimtarit, e permi-shenjta nuserore e virgjër, dhe ark' e art' e ndí-cime thesár' i Zotit Krisht, sot po sillet me lavdí.

ne shtepín' e Perendise, dhe hirin brenda po na sjell, plot me Frymen e Shenjte; pra e hymnojne Engjejte me brohorí: Kjo ketú eshte, banesa e qëllshime.

### SHTËPIA

Kur shikónj Misteret e Perendise dhe hirin, qe i çfaqet Virgjërshes, gezohem dhe nuk di si ta tregónj me fjale, se Shen Maria u-lartesua permi krijesen e dukur dhe te padukur. Ndónese jam i habitur, prape kuxónj, edhe leçít, edhe lavderónj: Kjo ketú eshte banesa e qëllshime.

### SINAKSARI

Me njezét e nje te ketí múaji, kujtojme Hyrjen e Shen Marise, Kryezonjes sone, Hyjlíndeses, dhe gjithenjë Virgjërshes, ne Témpullin.

Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o Perendi, me shirona. Amín.

*Kendohen Zbritesoret e para (A) te Kershendéllave:*  
ZBRITESORET, T. I, KHRISTOS JENNATE

I - A. Ja Krishti lint lavderójeni; ja Krisht' i qellit vjen dilni prítene; ja Krishti mi dhenc ngréhuni; Zotin pra e kendoni lart e mi dhé, dhe me ngazellime, perhymnójeni me mall, popuj dhe me lavdí.

III - A. Perpara nga jetet, lart ne qell, ti ke lindur prej Atit si Bir, edhe tani prej Virgjërshes, si nje foshnje u-çfaq, o Krisht Perendi te

fálemi: Ti që na ngrite perpjetë me nder, o Zot i Shenjtë je.

IV - A. Shkop nga renja e Jesseut je, dhe lule prej asáj o Krisht, ke lulezuar prej Hyjlíndeses, prej mali hieplót, dhe të dendur me lisa, dhe umisherovë prej Marisë, dhe linde o Perendí: Zoti i fuqishim lavdí me ty.

V - A. O Zoti i paqes, o Atë me hir, për shpetimin e njëresve Engjellin, që paqen perendore sjell, dergove permi dhé; sot pra të udhëhequr me dritë Perendie, që menatë ngríhemi, dhe lavderojmë njeridáshesin.

VI - A. Si Profeti Shen Joná, pasi u-gëlltít në det, prej peshkut të math, dolli dhe nuk u-nga, gjithashtú taní, edhe Fjala e qellit Jesúj Shpetimtár, shkoj nga gjir' i Virgjereshes dhe Hyjlíndeses, se u-misherua pa pësím, edhe Nenen e la të pacénshime.

VII - A. Tre Djemat që u-rritnë besëmirc, trimërisht përbuznë úrdherin e shtýpesit, nga furra dhe zjarri nuk u-trempn' aspák, po në flage dhe në prush, me kengë fáleshin: O Perendí atëror, je i bekuar.

VIII - A. Furra vesçplote na tregój një shembell, të çudisë që shkeli natyrën, se ajó s' i dogji Tre Djemat që priti; ashtú dhe zjarri i qellit s' e ngau Virgjereshen aspák. Pra le të hymnójm' e le t' i fálemi: E bekonit të gjithë Zotin me zë të math, dhe e lartësoni permi të gjitha jetet.

## MADHËSHTIMET E MËNGJËZIT, T. IV

*Engjëjte, kur pane Virgjereshen, në Témpullin çudíteshin, si hyri brenda n' Alltarin, në të Shenjtat e Shenjterores.*

Si një arkë mistike me shpirt, një dorë e pabesë s' duhet të prekë; vetëm buzë prej besnikësh duhet të thërresin, me zë engjëllor me gas dhe pa pushím, dhe me brohorí le të thonë, je m' e lartë se të gjithë pa fjale, Virgjereshe Marí.

*T. I. O shpirt madheshtojë, Marinë Virgjereshen, që hyri në Alltarin, e Témpullit të Zotit (3 here).*

*LAVDI. O shpirt madheshtojë, Trinín' e lavderuar, të Shenjt' e të pandarë.*

*TANI. O shpirt madheshtojë, Marinë Virgjereshen, më të lavderuar, se Forcat Engjëllorë.*

ZBRITËSORE, KËNGA IX - A. Mistër të çudim, shikónj dhe s' e marr dot vesh; se si qëll një shpellë ndrit; fron Kerubík u-çfàq Virgjeresha; dhe grazhdi i vogël, e nxuri atë që bota nuk e nxe, Krishtin Perendí; e madheshtojmë pra me kengë sot.

## DËRGIMËSORJA, T. II, TIS MATHITES

Të parëlajmëruarën, prej çdo Profeti sheshit, si shtemb' e pllakë dhe si shkop, malí e pacinuar, Marinë Zonjen e Shenjtë, Nenen e Shpetimtarit, me bes' e lavderojmë sot, se në Témpullin hyri plot me lavdí, dhe në Shenjteroren e Perëndisë, n' alltarin e të Shénjtave, si nuse engjëllorë (3 here).

## LAVDGRIMET, T. I, TON URANION

Me drita dhe me llambadhe po e percjellin sot, n' alltarin Virgjereshen, vajzat me lavderime, dhe t' arthmen lajmerojne me profeti, se Shen Maria Hyjlindese, posi nje tempull i shenjte i Zotit Krisht, me lavdi po hyn ne tempullin.

Sipas premtimit te Zotit nje bije me lavdi, Maria Virgjereshe, u-tregua ne bote, m' e larta nga te gjitha pra beserisht, sillet brenda ne tempullin, edhe deshiren e zemra na mbaron, njerezise dhe prinderve.

Me buke qelli u-rrite Mari Hyjlindese, ne tempullin e Zotit, edhe botes mire, nje buke jete Fjalën dhe Perendi, si nje tempull i Zotit Krisht, dhe u-vlesove me Shpirtin mistikerisht, si nje nuse e qellshime.

U-hapne portat e Kishes per ty Hyjlindese; si Kish' e gjithesisë, edhe fronti i Zotit, po shpiresh me lavdi per brenda n' alltar, prej Hyjprindit Shen Joakim, dhe si dhurate blatohesh dhe si kurbán, edhe behesh Nen' e Zotit Krisht.

LAVDI DHE TANI, T. II. Sillet ne Tempull sot, prej Engjejve Maria, si Nen' e Jesú Krishtit, dhe hyn n' alltar te shenjte, me kenge brohoritese.

## APOSTULLI

Madheshtoje Zotin, o shpirti im. Se e hodhi syrin mi sherbetoren e perunjur.

Prej Letres se Palit per Filipianet.

Vellezer, kini atë fryme, qe ka patur Jesú Krishti, i cili kishte formen e Perendise, dhe ishte barabár me Perendine, po e zbriti veten e tij aq sa mori formen e sherbetorit edhe shembellsine e njeriut, edhe u-çfaq si njeri nga fytyra, dhe e perunji veten e tij, edhe u-tregua i bindur gjer ne vdekje, dhe ne vdekje mi Kryqin. Perandáj edhe Perendia e lartesój, edhe i dha nje emer permi çdo emer tjater, qe perpara atí te pergjunjen te gjithë atá, qe jane ne qell edhe mi dhé edhe ne ne dhene, edhe çdo gjuhe te refenje se Jesú Krishti eshte Zot per lavdine e Perendise dhe Atit.

## UNGJILLI PAS LUKAJT

M' atë kohe, Jesú hyri ne nje katunt, edhe nje grua, e quajtur Martha, e priti ne shtepine e vete. Edhe ajó kishte nje moter, te quajtur Maria, e cila ndenji ne kembet e Jesújt, edhe degjonte fjale e tij. Po Martha sillej rotull, dhe sherbente rende, pastáj qendroj, edhe tha: "O Zot, valle nuke te ha malli qe ime-moter me ka lenë te sherbenj e vetem? Thúaj-i, te lutem, te me ndihmonje." Dhe Jesú u-pergjéq, edhe i tha: "Martha, Martha, po kujdesesh edhe trubullohesh per shume gjera, po vetem per nje gje eshte nevojë; dhe Maria ka zgjedhur pjesen e mire, e cila nuke do te rembehet prej saj." Edhe kur po i thoshte ketó fjale, nje grua prej pópullit e ngriti zerin, edhe i tha: "Lum' barku, qe te ka mbajtur, edhe siset, qe ke thethitur." Po ay tha: "Jo, po lum' atá, qe

e degjojne fjalen e Perendise, dhe e rúaajne.”

#### MADHESHTIMI I MESHES, T. IV.

*Engjejte, kur pane Virgjereshen, ne Tëmpullin çuditëshin, si hyri brenda n' Altarin, ne te Shenjtat e Shenjterores.*

Si nje arke mistike me shpirt, nje dore e pabese s' duhet ta preke, vetem buze prej besnikesh duhet te thërresin, me ze engjellór me gas dhe pa pushim, dhe me brohorí le te thone, je m' e lar-te se te gjithë pa fjale, Virgjereshe Marí.

#### KUNGATORJA

Do ta marr kupen e shpëtimimit, dhe do ta përthërrës emrin e Zotit.

*22 Filemoni, Apfia, Arkippi dhe Onesimi, Apostujte e Shenjte; Kekilia, Valeriani dhe Tiburti, Deshmoret e Shenjte.*

*23. Grigori, Ati yne i Shenjte, peshkopi i Akragantes; Amfilloki, Ati yne i Shenjte, peshkopi i Konjes.*

#### PERLESHORJA E GRIGORIT TE AKRAGANTES, T. T. IV.

O Perendí i Aterve, qe na sillesh gjithënjé, me miresí dhe butesí, mos e kursé perdellimin tent për né; me lutjet e Aterve tane, qeveris-e jeten tone me paqe.

*24. Klementi i Romes dhe Pjetri i Aleksandrise, Aterit tane te Shenjte dhe Hierodeshmore.*

#### PERLESHORJA E KLEMENTIT DHE E PJETRIT, T. T. IV.

O Perendí i Aterve tane, qe na sillesh gjithë-

një, me miresí dhe butesí, mos e kursé perdellimin tent për né; me lutjet e Aterve tane, qeveris-e jeten tone me paqe.

*25. Shen Ekaterina, Deshmorja e Madhe; Merkuri, Deshmori i Shenjte.*

#### PERLESHORJA E SHEN EKATERINES, T. T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Shqerra jote o Jesú, me ze te math po te thërrét: Dhenter ty te desherónj, dhe nat' e dite te kerkónj, dhe kryqesohem dhe varrosem tok me Pagezimin; edhe vuanj tok me ty, qe te gezohem tok me ty, edhe vdes për emrin tent, qe tok me ty te rronj ne qell; po si nje fli te shenjte prit-me mua qe për ty sakrifikohem. Degjona lutjet, edhe shpëtoji, shpirtet tona prej vdekjes.

#### THIRRTORET, T. I, TON URANION

Aleksandri' e Misirit sot po defrén me gas, se bije te ka patur, dhe shpërginjte ne Kishe, t' i ruan si thesár ne arke për né, pra kremtojme me bes' e mall, Ekaterine Deshmore kujtimin tent, nermjetó pra për te gjithë né.

Ekaterine kujtimin po ta kremtojme sot, se ti vertét i theve, ushterít' e armikut, me fjale dhe me vepr' i shtrive perdhé, oratorët e prófkave; pra nermjetó pranc Zotit dhe na shpëto, prej te gjith' heretíkeve.

Lum' ti Deshmore e Madhe Ekaterine me nam; se ne Siná ne malin, ku e pá Moisiu, ne flage te

padjegur ferren atjé, Perendia dhe Zoti Krisht, ta shpuri trupin ta ruan si nje thesár, gjer ne fundin e jéteve.

LAVDI DHE TANI, T. II. Hirin e Shpirtit Shenjt, ta fali Perendia, dhe e perbuze mbretin, me trimerín' e shpirtit, Dëshmór' e Madh' e Zotit Krisht.

#### PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Shpirti Shenjt te ndihmój, Merkúr Dëshmór i Shenjte, t' i thyesh Ethiopet, me armet dhe fitove, kuroren e Shenjtóreve.

Engjell i Zotit Krisht, prej qellit u-dergua, dhe plaget t' i sheronte, kur ishe i permbytur, prej gjakut o Dëshmór i Math.

Mbretin nuk e perfíll, statújave s' u falesh, dhe me litár te varrne, edhe me zjarr te doqne, Merkúr o Athlofór i Math.

LAVDI DHE TANI. Mbretin e kallezón, si nje pagán te çmendur, dhe Krishti Shpetimtari, te fali ne Parajse, kuroren e Dëshmóreve.

#### NDENJCSORET, T. I, TON TAFON SU

U-çfaqje trimerísht, o Dëshmore e lumur, per Zotin Jesú Krisht, u-perveshe per vojttjet, tiranin e qertove pra, si te çmendur dhe si pagán, oratóreve, u mbylle gojen e repte, dhe u-ngjite lart, ne lumerimet qellore, Dëshmore lavdí me ty.

LAVDI DHE TANI. Te drejtet prinder ke, Jokimin dhe Annen, dhe vjen ne Kische sot, si dhu-

rate per Zotin, e vogel nga versa je, qe jet' e ushqím na jep, ty po te bekón, Profeti plak Zaharia, pra te gjithë né, o Nen' e Zotit dhe Mbretit, me besë te fálemi.

#### T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Virgjereshe me lavdí, Ekaterina plot me hir, me fuqín' e Zotit Krisht, si u-forcua shpirterísht, me ngazellím po hyn ne mes t' arenës; tiranin e perbúz, me trimerí dhe kuxím, dhe nga turma nuk u-tremp, armiqesore pa fe, me brohorí kendonte pra me ze te larte dhe pa pushím: O Krisht i dashur, shpetóm' e prit-me, ne Parajsen e Engjejeve.

LAVDI DHE TANI. Sa pa lindur o Marí, per Perendine dhuretí, posa linde permi dhé, sipas zotimit prinderór, u-shpure menjehere perpara Zotit. Ne témpullin e math, Tempull i Zotit Krisht, si foshnje pa nje cen, midis llambádheve shkelqén, si nje kandíl i Dritës se paafrúarshme. E madhe eshte, e kremtja jote, o Virgjereshe Hyjlíndese.

#### T. T. IV, TO PROSTAKTHEN

Aleksandria e Egiptës pranc detit, te kremten tende po e lus me lavderime, dhe gezohet qe te lindi o Ekaterine; se vojte, me trimerí per Zotin Krisht, therrét pra, dyke u-mburrur me brohorí, o Dëshmore e ndérçime, qe je taní lart ne qell,

perpara Zotit Jesú Krisht, nermjetó gjithenjë per né.

LAVDI DHE TANI. Le te gezohet hymnografi Shen Davidi, le te kecenje Joakimi tok me Annen, se nje bij' e shenjte prej atyre lindi. Maria, si nje llambadhe sot po shkelqén, ne tempull, sot e gezuar hyn me lavdí, dhe até e bekój me mall, Profét' i math Zaharí, dhe thirri edhe tha me gas: Drit' e botes lavdí me ty.

#### SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te fishkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartesohe ne paqesí, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARGVARGU. Zoti ka bere çudira me Shenjtoret ne bote.

#### UNGGJILLI I MËNGJJEZIT PAS MATTHEUT

Zoti tha keté parabolle: Mbretëria e qellit shembellén me dhjete virgjresha, te cilat múarne llambat dhe dúallne per te pritur Dhénterin. Dhe pese prej ketyre ishin te ménçime, dhe pese te marra. Te marrat, kur i múarne llambat, nuke múarne edhe vaj; po te ménçimet, bashke me

llambat, múarne edhe vaj ner enet e tyre. Dhe meqéneqe Dhénteri vonój, i zuri gjumi te gjitha, edhe po flinin. Dhe ne mes te nates u-degjua nje klithme: "Ja ku vjen Dhénteri; dilni ta prisni." Atehere u-ngritne te gjitha virgjreshat, edhe ndreqne llambat. Edhe te marrat u thane te ménçimeve: "Na jepni ca vaj, se na u-shuan llambat." Po te ménçimet u-pergjeqne: "Jo, se nuke kemi mjaft per né dhe per ju, po mé mire shkoni, dhe blini vaj atjé, ku e shesin." Dhe kur até shkuan per te blere vaj, ardhi Dhénteri; dhe virgjreshat e ménçime, qe ishin gati, hyn bashke me Dhénterin ne dasme; dhe dera u-mbyll. Pastáj arthne edhe virgjreshat e marra, edhe thane: "O Zot, o Zot, hapna-e deren." Po Dhénteri u-pergjéq: "Me te vertete, me te vertete po ju thom qe nuke ju njoh." Pra, vigjelloni, se nuke dini as ditën as oren, ne te cilen vjen i Biri i njeriut.

*Psalmi 51 pa ze.*

LAVDI. Me nermjetimet e Athlofores, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

*Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.*

T. II. Lusim kujtimin tent, o Shen Ekaterine, se mbretin e perbuze, dhe proklamove Krishtin, dhe lutesh gjithenjë per né.

## SHKURTORJA, T. II, TA ANO.

Besnike me zell, me bujë brohoriteni, Dëshmoren me nam, lavdín' e të Krishtëreve, Ekaterinen; kjo n' arenë Jesun' e leçiti fáqeza, dhe e shkeli gjárpcrin, dhe mundi taborin e oratóreve.

## SHTËPIA

E urtë që prej foshnjërisë, Dëshmorja e Madhe Shen Ekaterina falej nat' e ditë, dhe e trimcruar prej Zotit edhe Shpëtimtarit tonë Jesú Krisht, i rrezój ídhullat, e perbuzi mbretin në arenë, e leçiti Krishterimin, dhe e mundi taborin e oratóreve.

## SINAKSARI

Me njezët e pesë të ketí múaji, kujtojmë Shen Ekaterinen, Dëshmoren e Madhe.

Gjithë sot, kujtojmë të një qint e pesëdhjetë Oratorët, të cilët e besuan Krishtin me anën e Shen Ekaterinës, dhe e mbaruan jetën të djegur në zjarr.

Gjithë sot, Shen Vasilisa, e shoqja e Maksentit, e mbarój jetën e vrarë me shpatë.

Gjithë sot, Shen Porfiri Stratellati edhe të dy qint ushtarët e mbaruan jetën të vrarë me shpatë.

Gjithë sot, kujtojmë Shen Merkurin, Dëshmorin e Math.

Gjithë sot, kujtojmë Pjetrin Hesikastin, Atin tonë Oshenár.

Gjithë sot, të gjashtë qint e shtatëdhjetë Dësh-

moret e Shenjtë mbaruan jetën të vrarë me shpatë.

Me nërmjetimet e tyre, o Perendí, mëshirona. Amín.

*Këndohen Zbritesoret e para (A) të Këshendëllave:*  
ZBRITESORET, T. I, KHRISTOS JENNATE

I - A. Ja Krishti lint lavdërojëni; ja Krisht' i qellit vjen dilni priteni; ja Krishti mi dhënë ngrëhuni; Zotin pra e këndonin lart e mi dhë, dhe me ngazëllime, perhymnojëni me mall, popuj dhe me lavdë.

III - A. Perpara nga jetët, lart në qell, ti ke lindur prej Atit si Bir, edhe taní prej Virgjëreshës, si një foshnjë u-çfaqë, o Krisht Perendí të fálemi: Ti që na ngritë perpjete me nder, o Zot i Shenjtë je.

IV - A. Shkop nga renja e Jesseut je, dhe lule prej asáj o Krisht, ke lulezuar prej Hyjlíndesës, prej mali hieplót, dhe të dëndur me lisa, dhe u-misherove prej Marisë, dhe lindë o Perendí: Zoti Zoti i fuqishim lavdë me ty.

V - A. O Zoti i paqes, o Atë me hir, për shpëtimin e njëresve Engjëllin, që paqen perëndore sjell, dërgove përmi dhë; sot pra të udhëhequr me dritë Perëndie, që menatë ngrihemi, dhe lavdërojmë njeridëshesin.

VI - A. Si Profeti Shen Joná, pasi u-gëllit në det, prej peshkut të math, doli dhe nuk u-nga,

gjithashtú taní, edhe Fjala e qellit Jesúj Shpetimtár, shkoj nga gjir' i Virgjereshes dhe Hyjlíndeses, se u-mishcrua pa pesím, edhe Nenen e la te pacénshime.

VII - A. Tre Djemat qe u-rritne besemire, trimerisht perbuzne úrdherin e shtýpesit, nga furra dhe zjarri nuk u-tremphi' aspák, po ne flage dhe ne prush, me kenge fáleshin: O Perendí ateorór, je i bekuar.

VIII - A. Furra vesplote na tregój nje shembell, te çudise qe shkeli natyren, se ajó s' i dogji Tre Djemat qe priti; ashtú dhe zjarri i qellit s' e ngau Virgjreshen aspák. Pra le ta hymnójm' e le t' i fálemi: E bekonit te gjithë Zotin me ze te math, dhe e lartesonit permi te gjitha jetet.

IX - A. Mistér te çudiçim, shikónj dhe s' e marr dot vesh; se si qell nje shpelle ndrit; fron Kerubík u-çfaq Virgjresha; dhe grazhdi i vogel, e nxuri até qe bota nuk e nxe, Krishtin Perendí; e madheshtojme pra me kenge sot.

#### DERGIMCSORET, T. II, EPESKEPSATO

Frymesove me kuxím, dhe trimerí te vírgjerat, Ekaterín' e ndrícime, Deshmór' e Madhe me lavdí, dhe fillosófeve pa ment, u dhé te kupetojne, çudín' e Hyjlíndeses.

E HYRJES. Ne te Shenjtat hyre sot, o Zonje dhe Hyjlíndese, edhe te priti me gczím, Profeti Zaharí me nam, edhe u-rrite me lavdí, me buke engjellore, n' Alltarin e Témpullit.

#### LAVDERIMET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Lusim kujtimin tent, o Shen Ekaterine, se munde oratorët, dhe proklamove sheshit, Jesune njeridáshesin.

Mbretin e kallezón, si nje pagán te çmendur, dhe Krishti Shpetimtari, te fali ne Parajse, kuroren e Deshmóreve.

Hirin e Shpirtit Shenjt, ta fali Perendia, dhe e perbuze mbretin, me trimerín' e shpirtit, Deshmór' e Madh' e Zotit Krisht.

LAVDI, T. II. Rrojte si Engjejte, o Shen Ekaterine, si lul' e Perendise, edhe me gjak fitove, kuroren e Deshmóreve.

TANI E HYRJES. Sillet ne Tempull sot, prej Engjejve Maria, si Nen' e Jesú Krishtit, dhe hyn n' alltár te shenjtc, me kenge brohorítese.

#### SHKURTORJA, T. IV, O IPSOTHIS

I permipaçmi Tempull i Shpetimtarit, e permi-shenjta nuserore e virgjër, dhe ark' e art' e ndrícime thesár' i Zotit Krisht, sot po sillet me lavdí, ne shtepín' e Perendise, dhe hirin brenda po na sjell, plot me Frymen e Shenjte, pra e hymnojne Engjejte me brohorí: Kjo ketú eshte, banesa e qëllshime.

#### APOSTULLI

Perendia ka bere çudira me Shenjtoret. Bekójeni Perendine ne Kishet.

Prej Letres se Palit per Gallatianet.

Vellezer, pa ardhur besa, ishim nene ligjen, dhe ishim te mbyllur per besen, e cila na u-zbulua mé pastáj. Pra, ligja ka qene mesónjesi yne, qe na rriti per drejtesimin e beses me Krishtin. Po taní qe ka ardhur besa, nuke jemi nene mesónjesisin mé. Se taní jini qe te gjithë bij te Perendise me besen e Jesú Krishtit. Se ju, qe u-pagezuat me Krishtin, jini veshur me Krishtin. S' ka Jahudí as Elín; s' ka rob as te lire; s' ka mashkull as femer; se qe te gjithë jini nje me Krishtin Jesú. Dhe posa jini besnike te Krishtit, atehere jini edhe bij te Abrahamit, edhe trashëgimtare te zotimit. Dua te them qe, sa kohe qe trashëgimtari esht i mitur, nuke ndryshón nga robi, ndónese esht i zoti i te gjithave; se eshte nene gardiane dhe kujdestare gjer ne kohen e caktuar prej atit. Gjithashtú edhe né, kur ishim te mitur, ishim te roberuar nene elementat e botes; po kur umbarua koha, Perendia dergój te Birin, qe lindi prej nje grúaje, qe u-unj nene ligjen, qe t' i çperblenje atá, qe ishin nene ligjen, dhe ta gëzojne adoptimin edhe atá.

### UNJILLI PAS MARKUT

M' até kohe, nje turme e madhe e pasonin dhe e shtrengonin Jesune. Dhe nje grua, e cila vúante nga rjedhja e gjakut qe prej dymbëdhjete vjeç, edhe ishte munduar keq prej shume mjekesh, edhe kishte harxhuar tere mallin e vetë, edhe jo vetem s' kishte pare asnjé dobí, po ishte

semurur mé rende, kur degjój per Jesune, i vajti midis turmes prápazaj, dhe e preku roben e tij, se thoshte qe: "Edhe sikúr tja prek robot vetem, do te sherohem." Dhe menjehere i pushój rjedhja e gjakut edhe ndjeu qe trupi iu-sherua nga ajó semundje. Edhe Jesú menjehere e ndjeu fuqine, qe i dolli nga trupi, dhe u-kthye nga pópulli, dhe tha: "Cili mi preku robot?" Dhe Dishépujte u-pergjeqne: "E sheh pópullin, qe te shtrengón, dhe na pyét, cili me preku?" Po Jesú shikonte rotull qe ta gjente até, qe e kishte prekur. Dhe grúaja u-tremp, edhe ardhi e drithteruar, dyke ditur seç i kishte ngjarë, dhe i ra ner kembe, dhe ia tha tere te verteten. Dhe Jesú i tha: "Bije, besa jote te shpetój; shko ne paqe, dhe qofsh e shendoshe nga semundja jote."

### KUNGATORJA

Perendia ka bere çudira me Shenjtoret.

26. *Alipi Kioniti dhe Nikoni i Pendimit, Aterit tane Oshenare.*

27. *Jakobi Persani, Deshmori i Math.*

### PERLGSHORJA E SHEN JAKOBIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmori yt o Zot, me vojte lot e mundím, kurore te ndrícime prej teje mori sot, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, ka rrezuar tiranet, dhe ka dermuar djajte, e kuxímt' e te dobet; aý per né po lutet o Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

28. *Stefani i Ri, Deshmori i Shenjte dhe Oshenár; Irenarku, Deshmori i Shenjte.*

PERLESHORJA E STEFANIT TË RI,  
T. IV, O IPSOTHIS

Si i stervitur Ashketí nëper malet, dermove gjithë ushterít' e armikut, me armet e pamúndura të Kryqit Shpetimtár, dhe u-nise për deshmím, u-perveshe si burrë, vrave Mbretin Koproním, me sepatën e besës, dhe për këtë kurorë merr në qell, Deshmór i Shenjte, Stefán i kujtúarshim.

29. *Paramoni dhe Fillumeni, Deshmoret e Shenjte.*

30. *Shen Andreu, Apostulli i Shenjte, i lavderuar dhe emer-shkelqyer.*

PERLESHORJA E SHEN ANDREUT, T. IV.

Si i pareftúari i Apostujve, dhe velláj i Kryetarit, lutju Zotit të gjithesisë o Shen André, t' i fale paqen botës së tërë, dhe shpírteve tona përdellimin e math.

THIRRTORET, T. T. IV, TI IMAS.

Si të të levdojmë o Apostúll? Si një qell që na tregove, çdo lavdí të Zotit Krisht; shkrepétím që e shkelqeve, tërë botën me ndriçím; si re e cila derdhi shi prej qiellit; si enë plot me verë të çudíçime, që u jep defrím dhe urtesí, zémrave dhe gjithë shpírteve. Të lútemi, nermjetó për në dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostúll? Si një lumë të Pa-

rajses, që na rjeth e na vadít; si një arke me një dhjatë, që na falí Zotit Krisht; si díell shpírtetór që na ndriçón me gas; si dritë që shkelqén në mes të Kísheve; Buk' e Shenjte e Alltáreve, Kup' e Kungates së Shpírtit Shenjt. Të lútemi, nermjetó për në dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostúll? Meshetár për sakramentat, perendore të Jesújt; themeltár i Krishterimit, që në Kishën predikón; që pllakat ke latuar të kumándave, që ligjen ke përhapur, dhe një hir të ri, që nga Sión' e Proféteve, e proklamove o Shen André. Të lútemi, nermjetó për në dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostúll? Si thesár të pasurive, të panúmerta në qell; a si mjek a si sheronjes, për çdo zëmër dhe çdo shpírt; si shokun e patundur dhe leçítesin, e dógmave të mirelajmërúara; tituj ke të shum' o Shen André, dhe je një pus i virtútave. Të lútemi, nermjetó për në dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostúll? Si Dishepull që leçite, Shpetimtarin Jesú Krisht; si një mjek që pasionet, i sherón për çdo besník; si díell shpírtetór që na ndriçón me gas; kollonc dhe themél i gjithë Kísheve; ti që përhapë o André, Ungjillin e Zotit Krisht. Të lútemi, nermjetó për në dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostúll? Meshetár i urtesisë, i vertetë dhe besník, ti që shkrove dhe leçite, çdo mesím dhe porrosí, kollón' e gjithë Kísheve të

Zotit Krisht, keshtjéll' e patronditur e besnikëve. Te shuma dhe te panúmerta, dhuratat e doktrinave. Te lútemi, nermjetó per né dhe na shpetó.

LAVDI DHE TANI, T. II. Rjetat e pishqeve, André i neverite, edhe gjahtár i Krishtit, u-bere dhe u çpalle, Ungjillin mekátareve.

PASVARGJET, T. T. IV, O TU PARADHOKSU

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Aý qe ish peshkatár, na u-çfaq Apostúll taní, dhe gjahtár i njëresve, peshkatari i qiellit; me rjete fjalësh, kombet i ze si pishq; me tonje Kÿryqi, boten perpjét' e heq. Oh ç' fare gjah te math, na i solli Zotit Krisht ky Shenjt i Math! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Na e dergój Zot' i Math, Shen Andrenc prej qiellit, dele midis új-qerve, po aý nuk u-tremp aspák, bishat i beri, shqerra me bes' e fe; boten e tere, me predikím e ndroj. Sa vepra pa tregím, na ke ber' o Apostúll i Zotit Krisht! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Si pus per né po burón, uj' e vala me urtesí, per te gjithë njërczit, Apostulli i Zotit Krisht; prej tij doktrinát, rjedhin posi luménj, hir dhe sherime, kunder lengátave. Sa vepra me lavdí, dhe çudí ke bere ti o Shen André! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

LAVDI DHE TANI, T. II. Rjetat me vrap i lé, dhe Krishtit pas i vajte, dhe njërczit i ktheve, me

driten e Ungjillit, André dhe vdiqe si Dëshmór.

NDENJESORET, T. I, TON TAFON SU

Dishepull me lavdí, qe u-ftove i pari, prej Zotit Jesú Krisht, te kremtojme me hymne, André Shen Apostúll me nam, te therresim me ze te math: Grigjen e shpetó, e mpro e ruaj perhere, prej rezíkeve, prej çdo nevoje dhe helmi, dhe gjithë mundímeve.

LAVDI DHE TANI. O Zonje Shen Marí, en' e shenjte e Zotit, na ngrer dhe na shpetó, né qe humpme çdo shprese, qe vdesim dhe mbýtemi, neper llomat e fájeve, ti e vetem je, shpetím i çdo mekátari, ti je ndíhmese, dhe ti je mprojtje e forte, e gjithë besnikëve.

T. III, THIAS PISTEOS

Ti i pari je, qe gjete Krishtin, nga Dishépujte, André i lumur, qe ke leçitur porosít' e tij me ze te math, dhe fluturove neper boten kudó si zok, edhe i ndrite gjithë kombet dhe pópujte; pra iu-lut atí, o Shenjt Apostúll i Math, tu fale perdelimin gjithë njëresve.

LAVDI DHE TANI. Zonje Shen Marí, banés' e Fjalës, Nen' e Zotit Krisht, o Virgjereshe, qe kapercén nga bukuria gjithë Çngjete, hith nje sy permi né qe te lútemi, se prej mekátave te zeza po mbýtemi. Birit pra iu-lut, o Nene Marí Hyjlíndese, shpetimin te na fale mekátareve.

## T. T. I, TON SINANARKHON

Apostullin André le ta lavderojme sot, Ungjillorin e Fjalës edhe leçitësin, predikónjesin e kómbeve dhe pópujve, se na mesój dhe na tregój, si ta njohim Zotin Krisht, të vétëmin Bir të Zotit; dhe nermjetón pranë tij pa prerë, për shpëtimin e besnikëve.

LAVDI DHE TANI. Virgjërëshe dhe Nënë Marí Hyjlíndëse, që hidherimin e Eves e ktheve në gezím, të hymnojme në besnikët dhe të fálemi, se na çlirove plotërisht, nga mallkimi prinderór o Zonj' e përmibekuar; nermjetó pra për në pa prerë, që të shpëtojmë prej rezíkeve.

## SHALLESA KREMTORE

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojnë, po ti perkrah-më dhe shpëtojmë, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionen, do të turpërohëni prej Zotit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqësi, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisore mistikërisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërë krijesën për jetelindje.

PARCVARGU. Fama e tij u-perháp në tërë botën.

## UNGJILLI I MËNGJËZIT PAS MATTHEUT

M' atë kohë, Jesúj, tek po bariste anës detit të

Galilese, pá dy vellezer, Simonin, i cili quhej Pjetër, edhe Andreu të vellán' e tij, që po hithnin rjeten në detin, se ishin peshkatarë, dhe u tha: "Ejani pas meje, dhe unë do tju bënj peshkatarë njërezish." Edhe atá menjëherë i lanë rjetat, edhe i ranë pas. Edhe pasi shkoj s' andejmi, pá dy vellezer të tjerë, Jakobin të birin e Zebedeut, edhe Joanin, të vellán' e tij, tok me Zebedeun, t' atin e tyre, që po ndreqnin rjetat në anien e vetë, dhe i thirri. Dhe atá menjëherë e lanë anien dhe t' atin e vetë, dhe i ranë pas. Edhe Jesúj shetitte nëpër tërë Galileë, edhe predikonte në sinagogat e tyre, edhe leçitë Ungjillin e Mbreterisë, edhe shëronte çdo sëmundje dhe çdo lengatë nëpër pópullin.

*Psalmi 51 pa zë.*

LAVDI. Me nermjetimet e Apostúllit, o mëshirëplót, shúaji paudhësít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndëses, o mëshirëplót, shúaji paudhësít' e mia.

*Mëshirome, o Perëndí meshirëplót, edhe shúaji paudhësít' e mia.*

T. II. I parëftúari, André që ke pësuar, si vetë Shpëtimtari, për në pa prerë lutu, shpëtona prej demóneve.

## SHKURTORJA, T. II, TIN EN PRESVIES

Andreu burrin më emer edhe më punë, edhe të parin Dishepull të Shpëtimtarit, edhe të vella-

ne e Kryefrónesit, le ta kendojme se atí edhe ne-  
ve na therrét: E gjetme çlirónjcsin pra prítëni.

### SHTËPIA

Davidi qe lártazi e ndalón mekatarin t' i tre-  
gonje lavdite e Perendise, po na jep mesime per  
punen e bescs, dhe na keshillón me lote te shuma.  
Degjójani zerin sot, edhe mos e hidheroni si Isra-  
eli, se na thote me Psalmin pasonjes: Kendójëni  
Zotin mi tere dhene! E gjetme çlirónjcsin! Pra,  
prítëni!

### SINAKSARI

Me tridhjetë te ketí múaji, kujtojme Shen An-  
dreu, Apostullin e Parëftuar, te lavderuar dhe  
emershkelqyer.

Gjithe sot, kujtojme Frumentin, Atin tone O-  
shenár, peshkopin e Hindit.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshiro-  
na. Amín.

*Kendohen Zbritesoret e para (A) te Kershendéllave:*

### ZBRITËSORET, T. I, KHRISTOS JENNATE

I - A. Ja Krishti lint lavderójëni; ja Krisht' i  
qellit vjen dilni prítëni; ja Krishti mi dhene  
ngréhuni; Zotin pra e kendoni lart e mi dhé, dhe  
me ngazellime, perhymnójëni me mall, popuj  
dhe me lavdí.

III - A. Perpara nga jetet, lart ne qell, ti ke  
lindur prej Atit si Bir, edhe taní prej Virgjere-

shes, si nje foshnje u-çfaqë, o Krisht Perendí te  
fálemi: Ti qe na ngrite perpjetë me nder, o Zot  
i Shenjte je.

IV - A. Shkop nga renja e Jesseut je, dhe lule  
prej asáj o Krisht, ke lulezuar prej Hyjlíndeses,  
prej mali hieplót, dhe te dendur me lisa, dhe u-  
misherove prej Marise, dhe linde o Perendí: Zoti  
i fuqishim lavdí me ty.

V - A. O Zoti i paqes, o Ate me hir, per shpeti-  
min e njéresve Engjellin, qe paqen perendore  
sjell, dergove permi dhé; sot pra te udhehequr  
me drite Perendie, qe menate ngríhemi, dhe lav-  
derojme njeridáshesin.

VI - A. Si Profeti Shen Joná, passi u-gelltít  
ne det, prej peshkut te math, dolli dhe nuk u-nga,  
gjithashtú taní, edhe Fjala e qellit Jesúj Shpe-  
timtár, shkoj nga gjir' i Virgjereshes dhe Hyj-  
líndeses, se u-misherua pa pcsím, edhe Nenen e  
la te pacénshime.

VII - A. Tre Djemat qe u-rritne besemire, tri-  
merisht perbuzne úrdherin e shtýpesit, nga fu-  
rra dhe zjarri nuk u-trempn' aspák, po ne flage  
dhe ne prush, me kenge fáleshin: O Perendí ate-  
rór, je i bekuar.

VIII - A. Furra vesçplote na tregój nje shem-  
bell, te çudise qe shkeli natyren, se ajó s' i dogji  
Tre Djemat qe priti; ashtú dhe zjarri i qellit s' e  
ngau Virgjreshen aspák. Pra le ta hymnójm' e  
le t' i fálemi: E bekoni te gjithë Zotin me ze te  
math, dhe e lartësoni permi te gjitha jetet.

IX - A. Mistër të çudiçim, shikónj dhe s' e marr dot vesh; se si qell një shpelle ndritë frón Kerubík u-çfaq Virgjresha; dhe grazhdë i vogël, e nxuri atë që bota nuk e nxe, Krishtin Perëndí; e madheshtojmë pra me kenge sot.

### DERGIMCSORET, T. III, EPESKEPSATO

Shpetimtari Zoti Krisht, posa të gjeti të thirri, të parin prej Dishépujve, André o Apostull me nam, pra si i Përcftuari, dhe vlláj i Pjetrit falna, shpetimin e shpírteve.

Na lindi o Hyjlíndese, Jesús Krishtin Perëndí, që tërë botën e shpëtó, nga Ferri i demóneve; shpëtona nga semundjet pra, nga helmet dhe mekatat, me lutjet e dhémpshura.

### LAVDERIMET, T. I, TON URANION

O Bethsaide gezohu se ja luadhi yt, na ndriti dhe na falí dy zambake dy lule, Shen Pjetrin dhe Andrénc mistikerísht, dy leçites të Zotit Krisht, me hir qëllor të mirosur dhe me bekím, që deshman me trimerí.

André këcé dhe gezohu se prite Díellin, dhe Dritën edhe Fjalën, dhe lavdinc qëllorë, dhe Krishtin jetedhënc dhe Shpetimtar, e leçite me bes' e mall; atí iu-lut pa pushuar për gjithë né, për shpetimin e besnikëve.

O Apostull i degjuar i Shpetimtarit Jesús, u-zgjodhe si i pari, për leçitjen e Fjalës; Shen Pjetrin kur e pé i thirre o vlla: Ja Messia ja Zoti

Krisht, ja ku e gjetmë atë që na lajmeró, çdo Profét i Shkriptúrave.

LAVDI, T. T. IV. Le të lavdërojmë Shen Andrénc, leçitesin e besës, dhe shërbëtorin e Fjalës, se i çliró, njërezit nga Ferri me anën e Kryqit, edhe i shpuri në udhën e Perëndisë me anën e Ungjillit, edhe nërmjetón gjithënjë për shpetimin e besnikëve.

TANI. Hyjlíndesen Bethlehém, prit-e se ja ku po të vjen; dritën që s' përcndón, do të lindë për njerinë; Engjëjte çuditën në qëllin lart, njërezit këdojnë kudó përmi dhé. Magë që nga Lindja, tri dhuratat sillini dhe blatójini. Barínj e lavdëroni, Trishenjtorin këdojnë me fýejtë. Çdo frymësór, e këdoftë Zotin e jetës.

### SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS

Virgjresha sot po vjen, në Bethlehém për të lindur, Fjalën e përjétsime, brenda në shpellën se fshehti. Vallezó, e tërë bota dyke degjuar, lavdëró, bashkë me Engjëjt' e me Barinjte, Perëndín' e ameshuar, që desh të çfaqet, si djal' i ri përmi dhé.

*Kjo Shkurtore këndohet në Meshën pas Hyrjes së Vogel që më 26 të Nentorit gjer më 24 të Dhjetorit.*

### APOSTULLI

Fama e tij u-perháp në tërë botën. Qelli tregón lavdinc e Perëndisë.

Prej Letres I së Palit për Korinthianët.

Vellezer, Perëndia na çfaqí né Apostujtë si të

funtme ne vdekje e sipër, se u-beme theater për botën edhe për ƒngjelltë edhe për njërczit. Në të marrë për Krishtin, dhe ju të mënjim më Krish-tin; në të dobët, edhe ju të fortë; ju të lavderuar, edhe në të ƒnderuar. Edhe gjer në orën e tanish-me kemi urí edhe etje, edhe jemi të ƒveshur edhe të rrahur edhe të arratisur edhe të munduar, dy-ke punuar më dúartë tona; kur sháhemi, bekoj-me; kur ndíqemi, durojme; kur poshteróhemi, fá-lemi; jemi bërë si gatrat e botës edhe si plehet e të gjítheve gjer taní. Nuk jua shkruanj ketó qe tju turperónj, po qe tju keshillónj si bijt' e mi të dashur. Se munt të kini dhjetë mije mesonjes, po nukë kini shumë ater; se unë ju kam lindur më Jesús Krishtin më anën e Ungjillit. Ju lutem, pra, bëhuni imitatorët e mi.

### UNGGJILLI PAS JOANIT

M' atë kohë, Joani ishte më dy Dishepuj të tij, dhe e pá Jesunë kur po bariste, dhe tha: "Ja qengji i Perëndisë." Dhe të dy Dishépujtë e de-gjuan qe foli keshtú, dhe i ranë pas Jesúsjt. Edhe Jesús u-kthye, dhe i pá qe po i venin pas, edhe u tha: "ƒ doni?" Dhe atá e pyetnë: "Rabbi, dome-thënë Mesonjes, ku banón?" Edhe Jesús u-per-gjéq: "Eni dhe shikoni." Dhe atá vajtin, edhe pa-në se ku banonte, dhe qendruan atë ditë më atë, se ora ishte nja dhjetë. Një prej atyre, qe e de-gjuan Joanin të flasë, dhe pastáj i ranë pas Je-súsjt, ishte Andreu, i velláj i Simón Pjetrit. Edhe

Andreu për se pari e hasi Simonin, të vellanë, dhe i tha: "E gjetmë Messinë, domethënë Krish-tin." Edhe ia solli Jesúsjt. Edhe kur e pá Jesús, i tha: "Ti je Simoni, i biri Jonájti; ti do të quhesh Kefá, domethënë Gur.

### KUNGATORJA

Fama e tij u-perháp në tërë botën.